

Përmbaju ose Mbyll

Shtatë vjet shkelje ligjore vdekjeprurëse nga termocentralet e qymyrit të Ballkanit Perëndimor



Ky botim është financuar pjesërisht nga Bashkimi Evropian. Megjithatë, pikëpamjet dhe opinionet e shprehura janë vetëm të autorit/autorëve dhe nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht pikëpamjet dhe opinionet e Bashkimit Evropian ose CINEA-s. As Bashkimi Evropian dhe as subjekti që jep grantin nuk mund të mbahen përgjegjës për to.



Sweden
Sverige

Ky publikim është financuar nga Agjencia Suedeze për Bashkëpunim Ndërkombëtar për Zhvillim, Sida. Përgjegjësia për përmbajtjen i takon tërësisht autorit. Sida nuk ndan domosdoshmërisht pikëpamjet dhe interpretimet e shprehura.

Hulumtimi dhe shkrimi i raportit:

Ioana Ciuta, CEE Bankwatch Network

Pippa Gallop, CEE Bankwatch Network

Davor Pehchevski, CEE Bankwatch Network

Mirënjohje

Elena Nikolovska, Qendra për Hulumtime dhe Informata Mjedisore Eko-svest

Hristina Vojvodić, Instituti Rregullator i Energjisë së Rinovueshme dhe Mjedisit (RERI)

Mirko Popović, Instituti Rregullator i Energjisë së Rinovueshme dhe Mjedisit (RERI)

Redžib Skomorac, Qendra për Mjedis

Redaktimi

Emily Gray, CEE Bankwatch Network

Fotografia e kopertinës

Termocentrali i Bitolës, Maqedoni e Veriut, Foto: CEE Bankwatch Network

Kopertina e prapme

Miniera e qymyrit në Hade, Obiliq, Kosovë

Foto: Matteo Trevisan, realizuar si pjesë e projektit fotografik me titull "Më i nevojshëm se dielli"

Dizajni

Milan Trivić

Ky raport është mbështetur nga organizatat e mëposhtme:



Përmbajtja

Fjalorth i termave	5
Përmbledhje e përgjithshme	6
Hyrje	9
Pasqyra rajonale e emetimeve të ndotësve	10
CBAM po vjen, megjithatë asnjë shtet nuk ka ndonjë plan të qartë	16
Profillet e shteteve	18
Bosnja dhe Hercegovina	18
Kosova	24
Mali i Zi	28
Maqedonia e Veriut	32
Serbia	36
Konkluzione	42
Rekomandime	43
Shtojca 1: Materialet dhe metodologjia	47

Përmbaju ose Mbyll 2025

Shtatë vjet shkelje ligjore vdekjeprurëse nga termocentralet e qymyrit të Ballkanit Perëndimor

www.complyorclose.org

Fjalorth i termave

CBAM – Mekanizmi i Rregullimit të Kufirit të Karbonit. Ky instrument synon të përcaktojë një çmim të drejtë për karbonin e emetuar gjatë prodhimit të produkteve nga sektorë të caktuar të cilat eksportohen në BE, përfshirë këtu edhe energjinë elektrike, dhe të inkurajojë një prodhim industrial më të pastër në vendet jashtë BE. Faza e saj tranzicionale filloi në vitin 2023 dhe nga 1 janari 2026 do të aplikohen tarifat për importin e mallrave në BE.

De-NO_x – Pajisje për zvogëlimin e emetimeve të oksideve të azotit

De-SO_x – Pajisje për zvogëlimin e emetimeve të oksideve të sulfurit

ELV – Vlera Kufitare e Emetimeve. Kjo përfaqëson sasinë e lejuar të një lënde që përmbahet në gazrat e mbetura nga termocentrali i djegies, të cilat mund të shkarkohen në ajër gjatë një periudhe të caktuar; llogaritet masa e vëllimit të gazrave të mbetura, e shprehur në mg/Nm³.

Traktati i Komunitetit Energjetik – i nënshkruar në vitin 2005, i cili hyri në fuqi në vitin 2006 dhe synon të zgjerojë tregun energjetik të BE-së tek fqinjët e saj më të afërt, duke zbatuar legjislacionin e BE-së për energjinë, mjedisin dhe konkurrencën në sektorët e tyre energjetikë. Traktati aktualisht përfshin Bashkimin Evropian, Shqipërinë, Bosnjën dhe Hercegovinën, Gjeorgjinë, Kosovën, Moldavinë, Malin e Zi, Maqedoninë e Veriut, Serbinë dhe Ukrainën.

BE – Bashkimi Evropian

IED – Direktiva për Emetimet Industriale – Direktiva 2010/75/BE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, e 24 nëntorit 2010, mbi emetimet industriale (parandalimi dhe kontrolli i integruar i ndotjes). Vetëm Kapitulli III, Shtojca V dhe Neni 72(3)-(4) i Direktivës 2010/75/BE janë të zbatueshme në Komunitetin Energjetik.¹ Në BE, është përditësuar nga Direktiva 2024/1785 e 24 prillit 2024, por këto ndryshime ende nuk janë reflektuar në Traktatin e Komunitetit Energjetik.

LCP – termocentral i madh me djegie të brendshme. Ky përkufizohet si një tërësi pajisjesh teknike që përdoren për oksidimin e karburantit me qëllim përdorimin e nxehtësisë së gjeneruar me një hyrje termike nominale të barabartë ose më të madhe se 50 megavat (MW). Kjo përfshin termocentralet të tilla si termocentralet me karburante fosile ose biomasë dhe me djegie të brendshme në rafineritë e naftës.

LCP BREF – Dokumenti referues i teknikave më të mira në dispozicion për termocentralet e mëdha me djegie të brendshme, konkluzat e të cilit u bënë ligjërish të detyrueshme me Vendimin Zbatues të Komisionit (BE) 2017/1442 të datës 31 korrik 2017, që përfshin konkluzat e teknikave më të mira të disponueshme (BAT) dhe – pas një kontesti ligjor mbi baza procedurale – përsëri u rikonfirmuan në Vendimin Zbatues të Komisionit (BE) 2021/2326 të datës 30 nëntor 2021 për përfshirjen e konkluzave për teknikat më të mira të disponueshme (BAT), sipas Direktivës 2010/75/BE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit për termocentralet e mëdha me djegie të brendshme (të njoftuar me dokumentin C (2021) 8580.

LCPD – Direktiva për Termocentralet e Mëdha me Djegie të Brendshme – Direktiva 2001/80/KE mbi kufizimin e emetimeve të disa ndotësve në ajër nga termocentralet e mëdha me djegie të brendshme.

MWe – megavat energji elektrike – forma më e zakonshme e shprehjes së kapacitetit të një termocentrali.

MWth – inputi i vlerësuar termik i përgjithshëm i një termocentrali – vlerësimi i përdorur në legjislacionin e BE për të përcaktuar kategori të ndryshme të madhësive të termocentraleve. Në përgjithësi, është më e vështirë të arrihen përqendrime më të ulëta të emetimeve nga termocentralet më të vogla, kështu që kufijtë e ndotjes kategorizohen sipas madhësisë së tyre.

NERP – Plani Kombëtar për Zvogëlimin e Emetimeve – një mekanizëm fleksibil zbatimi sipas Direktivës për Termocentralet e Mëdha me Djegie të Brendshme në Komunitetin Energjetik, ku emetimet mund të zvogëlohen gradualisht duke marrë totalin e emetimeve të tyre së bashku dhe duke siguruar që ato janë më të ulëta se kufijtë maksimalë në ulje, të përcaktuara për vitet 2018, 2023, 2026 dhe 2027.

NO_x – oksidet e azotit

Opt-out – një mekanizëm fleksibil zbatimi sipas Direktivës për Termocentralet e Mëdha me Djegie të Brendshme, ku termocentralet mund të vonojnë investimet në pajisjet e kontrollit të ndotjes për sa kohë që ato kufizojnë funksionimin e tyre në 20 000 orë pune nga 1 janari 2018 deri më 31 dhjetor 2023. Çdo termocentral që operon pas këtyre orëve duhet të jetë në përputhje me rregullat për vlerat e lejuara të emetimeve nga termocentralet e reja, jo ato ekzistuese.

PM ose pluhur – grimca pluhuri

SO₂ – dioksid sulfidik

¹ Për më shumë informata, shih Sekretariatit e Komunitetit Energjetik, [Legjislacioni i Komunitetit Energjetik](#).

Përmbledhje e përgjithshme

Fundi i vitit 2024 shënoi shtatë vjet nga skadimi afatit që termocentralet në Ballkanin Perëndimor t'i përmbushin standardet e reja të ndotjes së ajrit. Megjithatë, ndotja vdekjeprurëse e ajrit nga termocentralet kryesisht të vjetruara të qymyrit në rajon, pothuajse nuk është ulur fare.

Në vitin 2024, emetimet e përgjithshme të SO₂ nga termocentralet e përfshira në Planet Kombëtare të Zvogëlimit të Emetimeve (NERP)² të Bosnjës dhe Hercegovinës, Kosovës, Maqedonisë së Veriut dhe Serbisë **ishin gjashtë herë më të larta se sa ishte e lejueshme**. Në terma absolutë ato kishin rënë pak, por për shkak se kufijtë e emetimeve për secilin vend ishin deri diku më të ulët në vitin 2024, shkella ishte relativisht më e lartë se në vitin 2023.

Për herë të parë, termocentralet e qymyrit të përfshira në NERP të Bosnjës dhe Hercegovinës ishin emetuesit më të lartë të SO₂ në rajon, me 212 840 tonë, ose 11,3 herë më shumë se sa vlera e lejuar. Kjo rezultoi kryesisht nga një rritje absolute e emetimeve, sesa nga tavanin në rënie të emetimeve. Pas saj vinte Serbia, me 205 925 tonë, ose 4,6 herë më shumë se sa vlera e lejuar.

Emetimet absolute të pluhurit gjithashtu ranë pak në vitin 2024 krahasuar me vitin 2023, por ishin 1,9 herë më të larta se sa lejohen nga NERP-të e vendeve, krahasuar me gati 1,8 herë në vitin 2023. Kosova, Bosnja dhe Hercegovina dhe Maqedonia e Veriut përsëri i tejkaluan tejmasë kufijtë e tyre kombëtarë për pluhurin.

Emetimet totale të oksideve të azotit nga termocentralet e NERP arritën në 1,4 herë më shumë se sa lejohej, për shkak të mungesës së investimeve në reduktimin e NO_x dhe kufijve vjetor në rënie për NO_x në NERP. Kosova, Bosnja dhe Hercegovina dhe Serbia i tejkaluan përsëri kufijtë e tyre. Kosova pati tejkalimin më të lartë - 3,1 herë më të lartë se kufiri i saj kombëtar.

Në terma absolutë, Ugljevik në Bosnjë dhe Hercegovinë, si një nga shkelësit më të hershëm të ndotjes, ishte përsëri njësi me emetimin më të lartë të SO₂ në rajon në vitin 2024, me 112 943 tonë ose 14 herë më të lartë se kufiri i vet individual. Pavarësisht instalimit të një njësie desulfurizimi dhe marrjes së një leje operimi për de-SO_x në nëntor 2021,³ emetimi i saj i SO₂ u rrit në vitin 2024 krahasuar me vitet 2022 dhe 2023. Operatori e pranon se de-SO_x nuk po funksionon kryesisht sepse është 'barrë ekonomike', dhe gjithnjë e më shumë po vihet në dyshim nëse ky projekt prej 85 milionë eurosh do të përdoret ndonjëherë siç duhet që termocentrali i Ugljevik të jetë në përputhje me standardet. Megjithatë, në janar 2024 operatori raportoi të ardhura rekord vjetore për vitin 2023.⁴

Edhe pse kufijtë individualë të njësive nuk janë obligativ – por vetëm ata në nivel vendi – shqyrtimi i shkeljeve të këtyre kufijve në nivel njësie mund të na ofrojë një tregues të mirë se ku nevojiten ndërhyrje të caktuara. **Në vitin 2024, jo më shumë se gjashtë njësi i tejkaluan kufijtë e tyre për emetimet e dioksidit të sulfurit për më shumë se 10 herë** – Ugljevik, Gacko, Tuzla 6 dhe Kakanj 7 në Bosnje dhe Hercegovinë; Kostolac A2 në Serbi; dhe Bitola B 1 & 2 në Maqedoninë e Veriut.

Për sa i përket pluhurit, emetuesi absolut më i lartë në rajon ishte Gacko në Bosnjë dhe Hercegovinë. Ky termocentral emetoi 3 339 tonë – 13,7 herë më shumë se sa vlera e lejuar. Kjo vlerë ishte edhe më e madhe se në vitin 2023, kur i emetoi 3 241 tonë.

Për oksidet e azotit, Nikola Tesla B në Serbi pati emetimet më të larta absolute në vitin 2024, me 12 418 tonë – edhe më të larta se emetimet e vitit 2023 prej 11 633 tonësh. Në terma relativë, Kosova A5 ishte ndotësi më i madh për sa i përket oksideve të azotit në vitin 2024, duke emetuar 3,9 herë më shumë se sa lejohet, ose 2 472 tonë.

Në dhjetor të vitit 2023, Këshilli Ministror i Komunitetit Energjetik konfirmoi shkeljet e NERP-së nga Bosnja dhe Hercegovina, Kosova dhe Maqedonia e Veriut.⁵ Rasti i Komunitetit Energjetik kundër Serbisë mbetet i hapur, por nuk është përshkallëzuar për shkak të investimeve të vazhdueshme në pajisjet e kontrollit të ndotjes.

² Si pjesë e detyrimeve të tyre për të respektuar Direktivën për Termocentralet e Mëdha me Djegie të Brendshme sipas Traktatit të Komunitetit Energjetik, katër vende të Ballkanit Perëndimor – Bosnja e Hercegovina, Kosova, Maqedonia e Veriut dhe Serbia – kanë hartuar Planet Kombëtare të Zvogëlimit të Emetimeve (NERP) që mbulojnë periudhën nga viti 2018 deri në vitin 2027. Në vend që të kërkohet që çdo termocentral i madh me djegie të brendshme të jetë në përputhje me vlerat kufitare të emetimeve nga Direktiva për Termocentralet e Mëdha me Djegie të Brendshme, e miratuar më 1 janar 2018, këto plane u lejojnë vendeve të llogarisin kufijtë kombëtarë të emetimeve të dioksidit sulfurik, oksidit të azotit dhe pluhurit, dhe gradualisht deri në vitin 2027 të zvogëlojnë emetimet e tyre të përgjithshme nga termocentralet e përzgjedhura të mëdha me djegie të brendshme të ndërtuara para vitit 1992. Në vitin 2027 të gjitha termocentralet e përfshira në NERP, individualisht do të duhet të jenë në përputhje jo vetëm me vlerat kufitare të emetimeve nga Direktiva e Termocentraleve të Mëdha me Djegie të Brendshme, por edhe me Pjesën 1 të Aneksit V të Direktivës 2010/75/BE për Emetimet Industriale.

³ Ministria e Planifikimit Hapësinor, Ndërtimeve dhe Ekologjisë e Republikës Srpska, [Vendimi nr. 15.03-360-164/21](#), 11 nëntor 2021.

⁴ RiTE Ugljevik, 'Planoviispunjeni100%', [RiTE Ugljevik](#), 5 janar 2024.

⁵ Këshilli Ministror i Komunitetit Energjetik, [Vendimi 2023/04/MC-EnC mbi mosrespektimin nga Republika e Maqedonisë së Veriut të Traktatit të Komunitetit Energjetik në Rastin ECS-7/21, Vendimi 2023/05/MC-EnC mbi dështimin e Kosovës* për të përmbushur Traktatin e Komunitetit Energjetik në Rastin ECS-8/21 dhe Vendimi 2023/06/MC-EnC mbi mosrespektimin nga Bosnja dhe Hercegovina të Traktatit të Komunitetit Energjetik në Rastin ECS-9/21, Komuniteti Energjetik](#), 14 dhjetor 2023.

Shkeljet e NERP-së përfaqësojnë vetëm një pjesë të ndotjes së paligjshme nga termocentralet e qymyrit. Në fund të vitit 2023 skadoi afati i fundit për mbylljen e termocentraleve që bien nën përjashtimin e jetëgjatësisë së kufizuar 'regjimi opt-out'. **Të tri vendet në Ballkanin Perëndimor me termocentrale me qymyr që i nënshtrohen kësaj dispozite - Bosnja dhe Hercegovina, Mali i Zi dhe Serbia – vazhduan ta shkelin atë edhe në vitin 2024.** Asnjë nga termocentralet nuk është mbyllur zyrtarisht ose nuk ka përfunduar rikonstruktionet për të arritur pajtueshmërinë me vlerat kufitare përkatëse të emetimeve, megjithëse Tuzla 3 në Bosnje dhe Hercegovinë raportoi zero orë operimi gjatë vitit. Këto termocentrale jo vetëm që kontribuan në ndotjen masive nga qymyri në rajon në vitin 2024, por as nuk janë pjesë e shifrave të nxjerra nga NERP më sipër.

Termocentrali Pljevlja i Malit të Zi ka operuar në mënyrë të jashtëligjshme që nga fundi i vitit 2020, kur i shfrytëzoi 20 000 orët e operimit të lejueshëm pas 1 janarit 2018. Në vitin 2022, atij iu bashkuan së pari njësitë Tuzla 4 dhe Kakanj 5 të Bosnjës dhe Hercegovinës dhe më pas termocentrali Morava i Serbisë. Që nga fundi i vitit 2023, kur të gjitha njësitë 'e regjimit opt-out' duhej të mbylleshin, termocentrali Kolubara A në Serbi gjithashtu ka vazhduar të funksionojë. Datat e mbylljes për të gjitha këto njësi mbeten ende të paqarta.

Për shkak të shkeljeve të dispozitave të regjimit 'opt-out', Sekretariati i Komunitetit Energjetik hapi raste për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve kundër Malit të Zi në prill 2021,⁶ Bosnjës dhe Hercegovinës në tetor 2022,⁷ dhe Serbisë në tetor 2023.⁸

Shkelje të tilla janë çështje jetë a vdekje. Siç tregoi edhe raporti ynë i vitit 2021, nga një total prej 19 000 vdekjesh të shkaktuara nga termocentralet e qymyrit në Ballkanin Perëndimor nga viti 2018 deri në vitin 2020, numri i përgjithshëm i vdekjeve gjatë kësaj periudhe të shkaktuara nga tejkalimet e kufijve të NERP ishte gati 12 000. Nuk ka asnjë arsye për të pritur që këto shifra të kenë rënë që atëherë.

Këto shkelje janë edhe çështje e sundimit të ligjit: autoritetet kombëtare nuk kanë arritur t'i zbatojnë rregulloret mjedisore në lidhje me ndërmarrjet shtetërore. **Edhe shtatë vjet pas kalimit të afatit të pajtueshmërisë me Direktivën e Termocentraleve të Mëdha me Djegie të Brendshme (LCPD) në Komunitetin Energjetik, asnjë operator i vetëm i termocentraleve nuk është gjobitur për këto shkelje.**

Pavarësisht problemeve teknike në rritje dhe problemeve të furnizimit me qymyr në disa raste, asnjë nga shtetet nuk ka plan të qartë, të përditësuar dhe realist për të arritur pajtueshmërinë me standarde dhe/ose mbylljen e të gjitha termocentraleve të tyre me qymyr. Edhe Maqedonia e Veriut, si lider rajonal për sa i përket instalimit të paneleve diellore, po devijon nga Plani i saj Kombëtar i Energjisë dhe Klimës (NECP), duke u shpërqendruar nga minierat e reja të qymyrit dhe planet e kushtueshme për instalimet e gazit, duke lejuar që data e heqjes graduale të qymyrit nga përdorimi në vitin 2027 të shtyhet të paktën deri në vitin 2030 dhe duke mos bërë pothuajse asgjë për ta adresuar ndotjen.

Mekanizmi i BE-së për Rregullimin e Kufirit të Karbonit (CBAM) do ta vështirësojë edhe më tej situatën, pasi që nga 1 janari 2026, importuesit e energjisë elektrike nga Ballkani Perëndimor në BE do të paguajnë tarifa bazuar në intensitetin e karbonit të furnizimit me energji elektrike të eksportuesit. Shtetet kanë pasur më shumë se pesë vjet kohë për t'i shmangur ndikimet e CBAM duke përmbushur kushtet e BE-së për përjashtime, por kanë dështuar në këtë aspekt.

Në përgjithësi, nivelet e ndotjes shtatë vjet pas afatit për zbatimin e LCPD-së mbeten çuditërisht të larta. Është humbur shumë kohë deri tani dhe ekziston një rrezik serioz i një heqjeje graduale dhe të paplanifikuar të qymyrit nga përdorimi, me ndikime të panevojshme e të ashpra në komunitetet e varura nga qymyri, ndikime të cilat mund të ishin shmangur me planifikim të duhur.

Qeveritë e Ballkanit Perëndimor duhet më në fund ta marrin përgjegjësinë për një heqje graduale e të menaxhuar të qymyrit nga përdorimi dhe të ndalojnë së lejuari që operatorët energjetikë të zvarrisin pafundësisht uljen e emetimeve. Nevoja për të ulur ndotjen dhe për të rritur efikasitetin e energjisë dhe format e qëndrueshme të energjisë së ripërtëritshme është më e madhe se kurrë.

Qeveritë dhe operatorët duhet t'i respektojnë zotimet e tyre: termocentralet që operojnë sipas regjimit të përjashtimit ('opt-out') duhet të mbyllen menjëherë,⁹ dhe termocentralet e përfshira në NERP duhet t'i respektojnë kufijtë e tyre. Një urgjencë e menjëhershme është që njësitë e desulfurizimit Ugljevik dhe Kostolac B duhet të fillojnë të funksionojnë siç duhet. Investimet e vazhdueshme në desulfurizim duhet të përshpejtohen dhe, ndërkohë, orët e funksionimit duhet të reduktohen për të ulur barrën e ndotjes.

⁶ Sekretariati i Komunitetit Energjetik, [Rasti ECS-15/21: Mali i Zi / Mjedi, Komuniteti Energjetik](#), qasur më 19 maj 2025.

⁷ Sekretariati i Komunitetit Energjetik, 'Sekretariati nis procedurën e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve kundër Bosnjës dhe Hercegovinës për shkelje të Direktivës për Termocentrale të Mëdha me Djegie të Brendshme në rastin e Tuzla 4 dhe Kakanj 5', [Komuniteti Energjetik](#), 28 tetor 2022.

⁸ Sekretariati i Komunitetit Energjetik, 'Sekretariati nis procedurën e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve kundër Serbisë për shkelje të Direktivës së Termocentraleve të Mëdha me Djegie të Brendshme në rastin e TC Morava', [Komuniteti Energjetik](#), 23 tetor 2023

⁹ Mundësia tjetër është t'i nënshtrohemi një rindërtimi të madh për të përmbushur vlerat kufitare të emetimeve për termocentralet e reja sipas Traktatit të Komunitetit Energjetik, siç po përpqet të bëjë termocentrali i Pljevljes, por ne jemi skeptikë se kjo do të ishte e realizueshme ekonomikisht.

Kërkesa duhet të reduktohet edhe me masa të tjera, si afatshkurtra ashtu edhe më sistematike, siç janë zvogëlimi i humbjeve në shpërndarje, izolimi i ndërtesave dhe përdorimi i pompave efçente të nxehtësisë për ngrohje në vend të ngrohësve me rezistencë elektrike. Masave të tilla duhet t'u jepet përparësi shumë më e lartë se sa u jepet tani.

Planet Kombëtare të Energjisë dhe Klimës (NECP) të shteteve, qofshin ato përfundimtare dhe/ose të përditësuara, duhet të përmbajnë plane realiste për një heqje graduale dhe të menaxhuar të qymyrit nga përdorimi, bazuar në gjendjen reale teknike të termocentraleve të tyre, nivelin e investimeve të nevojshme për t'i sjellë ato në përputhje me kontrollin e ndotjes, si dhe rezervat e tyre të linjitet dhe kapacitetin e prodhimit. Maqedonia e Veriut dhe Mali i Zi në veçanti duhet t'i përcaktojnë urgjentisht datat e heqjes graduale të qymyrit nga përdorimi, pasi ka të ngjarë që të jenë të parat në rajon.

Edhe pse është e qartë që përgjegjësia kryesore bie mbi qeveritë e Ballkanit Perëndimor, institucionet e BE-së duhet t'i përshpejtojnë veprimet e tyre, duke përdorur të gjitha mjetet në dispozicion, të tilla si kushtëzimi i financimit të BE-së dhe progresit të anëtarësimit me pajtueshmërinë me standarde; dërgimi i mesazheve të qarta politike publike; dhe sigurimi i financimit për një tranzicion të drejtë të rajoneve të qymyrit dhe kalimi në ngrohje të qëndrueshme qendrore.

Komisioni gjithashtu duhet të propozojë instrumente më të forta zbatimi për Traktatin e Komunitetit Energjetik, në dobi të shëndetit të njeriut dhe mjedisit. Nëse duam që Traktati të nxisë më tej dekarbonizimin dhe integrimin e tregut, mekanizmi i tij i zgjidhjes së mosmarrëveshjeve duhet të forcohet me dënime dekurajuese për shkeljet e bëra.

Miniera e qymyrit në Banovici, Bosnja dhe Hercegovina

Foto: Matteo Trevisan, realizuar si pjesë e projektit fotografik me titull "Më i nevojshëm se dielli"

Hyrje

Meqenëse afati i zbatimit i Direktivës për Termocentralet e Mëdha me Djegie të Brendshme (LCPD) në kuadër të Traktatit të Komunitetit Energjetik skadoi më 31 dhjetor 2017, ne kemi analizuar harmonizimin e vendeve të Ballkanit Perëndimor me Planet e tyre Kombëtare të Zvogëlimit të Emetimeve (NERP) në gjashtë botime të raportit 'Përmbaju ose Mbyll'. Këtë vit, ne shikojmë mospërputhje të vitit 2024 krahasuar me gjashtë vitet e mëparshme.

LCPD u përfshi në Traktatin e Komunitetit Energjetik në vitin 2005, kur edhe u nënshkrua. Për një traktat, qëllimi i të cilit është të hapë dhe unifikojë tregun energjetik të BE me atë të fqinjëve të saj të afërt në Evropën Juglindore dhe Lindore, përfshirja e legjislacionit mjedisor në Traktat është thelbësor për të përgatitur terren të përshtatshëm dhe për të parandaluar rrjedhjet e emetimeve, ku vendet me standarde më të dobëta mjedisore furnizojnë me energji elektrike BE-në.

NERP u mundëson vendeve të përmbledhin emetimet e dioksidit sulfurik (SO_2), oksideve të azotit (NO_x) dhe pluhurit nga disa ose të gjitha termocentralet e tyre, dhe ato të harmonizohen me një kufi të përgjithshëm të emetimeve, në vend që çdo termocentral të harmonizohet me kufijtë e emetimeve të përcaktuara në anekset e Direktivës. Zhvillimi i një NERP ishte vetëm një nga opsionet për harmonizim me Direktivën; vendet vendosën vetë nëse do të zhvillonin një të tillë apo jo.¹⁰ NERP lejon që termocentralet me djegie të brendshme të shmangin harmonizimin individual me vlerat kufitare të emetimeve (ELV) për termocentralet ekzistuese, të përcaktuara në Aneksin V, Pjesa 1 e LCPD, deri në vitin 2027. Në vend të kësaj, NERP vendos vlera kufitare periodike vjetore (2018, 2023, 2026 dhe 2027) që të gjitha emetimet e termocentraleve mbledhur së bashku nuk duhet t'i tejkalojnë, pavarësisht nga emetimet e tyre individuale. Deri në vitin 2027, çdo njësi duhet të përputhet individualisht me ELV-të nga Shtojca V, pjesa 1 e LCPD-së.

Termocentralet me performancë më të mirë për një ndotës të caktuar mund të kompensojnë për ato me performancë më të keqe, nëse plotësohet kufiri i përgjithshëm i përcaktuar. Prandaj, NERP-ët tashmë përfaqësojnë një kompromis në krahasim me harmonizimin e plotë nga secila njësi: dështimi për t'u harmonizuar me vlerat kufitare të përcaktuara në NERP është jashtëzakonisht problematik.

Termocentralet ekzistuese me djegie të brendshme kishin gjithashtu një opsion për t'u përjashtuar nga ELV e specifikuar në LCPD ose nga përfshirja në një NERP, nëse operatori përcaktohej për një funksionim të afatizuar. Kjo mundësoi që termocentralet të funksiononin për jo më shumë se 20 000 orë, duke filluar nga 1 janari 2018 dhe duke përfunduar jo më vonë se 31 dhjetor 2023, pa pasur nevojë të harmonizojë vlerat kufitare të emetimeve. Kushti vlente për njësitë për të cilat ishte planifikuar mbyllja ose rinovimi i plotë. Për të funksionuar përtej këtyre kufijve kohorë, termocentralet duhej të jenë harmonizuar jo vetëm me vlerat kufitare të emetimeve të LCPD, por edhe me ato më të reja dhe pak më të rrepta për termocentralet ekzistuese nga Shtojca V, Pjesa I e Direktivës së Emetimeve Industriale.

Termocentralet me qymyr të cilat janë në përputhshmëri me LCPD ende kanë implikime shëndetësore, por ato që nuk bëjnë këtë, rrisin rrezikshërinë e shëndetit dhe vdekjet e parakohshme në mënyrë të palejueshme dhe të paligjshme. Prandaj, harmonizimi me kufijtë e NERP dhe kushtet e ndalimit të funksionimit nuk janë vetëm çështje harmonizimi, por çështje jete a vdekjeje. Siç paraqitet në raportin tonë të vitit 2021, midis viteve 2018 dhe 2020, rreth 19 000 njerëz kanë vdekur si rezultat i ndotjes nga termocentralet e qymyrit të Ballkanin Perëndimor, nga të cilat 12 000 ishin për shkak të shkeljeve të vlerave të përcaktuara të emetimeve.¹¹ Fatkeqësisht, situata ka ndryshuar shumë pak që atëherë dhe këto shifra ka shumë të ngjarë të jenë të vlejshme edhe sot.

Prandaj, është e domosdoshme, madje e vonuar, të ndërmirren veprime për të zvogëluar ndotjen. Ky raport i shtatë 'Përmbaju ose Mbyll' merr parasysh të dhënat zyrtare të raportuara për vitin 2024, për të parë se si ka evoluar situata që nga viti 2018. Ai ofron një pasqyrë rajonale të rezultateve, së bashku me profilet e vendeve për Bosnjë e Hercegovinën, Kosovën, Malin e Zi, Maqedoninë e Veriut dhe Serbinë.

¹⁰ Përveç Malit të Zi, i cili ka vetëm një termocentral të madh me djegie të brendshme dhe për këtë arsye nuk mund ta kalkulojë totalin e disa termocentraleve për të krijuar një kufi kombëtar.

¹¹ Rrjeti CEE Bankwatch Network dhe Qendra Kërkimore për Energji dhe Ajër të Pastër (CREA), *Përmbaju ose Mbyll*, CEE Bankwatch Network, shtator 2021.

Pasqyra rajonale e emetimeve të ndotësve¹²

Deri më 31 dhjetor 2017, që paraqet afatin e fundit për harmonizim me LCPD në vendet e Komunitetit Energjetik, operatorët e termocentraleve të qymyrit në Ballkanin Perëndimor duhet të kenë investuar në pajisjet e kontrollit të ndotjes në një shkallë të mjaftueshme, në mënyrë që të harmonizojnë vlerat kufitare të emetimeve nga Direktiva, ose të paktën për të respektuar vlerat maksimale kombëtare të përcaktuara në Planet Kombëtare të Zvogëlimit të Emetimeve (NERP). Pas nënshkrimit të Traktatit, vendet kishin 12 vjet kohë për ta bërë këtë, pasi LCPD ka qenë një pjesë integrale e Traktatit që kur hyri në fuqi në vitin 2006.

Por pavarësisht kësaj, asnjë nga vendet me termocentrale të mëdha me djegie të brendshme¹³ deri në fillim të 2018, madje as edhe deri edhe në fund të vitit 2024, shtatë vjet më vonë, nuk siguroi që termocentralet e tyre me qymyr të harmonizohen me vlerat kufitare të emetimeve në nivel njësie siç parasheh Direktiva.

Me përjashtim të pajtueshmërisë së përkohshme dhe kryesisht të pashpjegueshme të Kosovës në vitin 2023, nga viti 2018 deri në fund të vitit 2024, asnjë nga katër vendet me NERP – Bosnja dhe Hercegovina (BiH), Kosova, Maqedonia e Veriut dhe Serbia – nuk i përmbushën kufijtë e dioksidit të sulfurit për të cilët ishin zotuar në NERP-të e tyre.

Prandaj, në mars të vitit 2021, Sekretariati i Komunitetit Energjetik hapi procese kontestimi kundër Bosnjë e Hercegovinës, Kosovës, Maqedonisë së Veriut dhe Serbisë për mosrespektimin e vlerave kufitare të përcaktuara në NERP-ët e tyre në vitet 2018 dhe 2019.¹⁴ Në shkurt të vitit 2022, bëri hapin e radhës duke ofruar argumente kundër Bosnjë e Hercegovinës, Kosovës dhe Maqedonisë së Veriut.¹⁵ Një opinion i argumentuar është hapi i dytë i këtij procesi, kur palës i kërkohet të korrigjojë çështjet e konstatuara të mosharmonizimit brenda një afati kohor prej dy muajsh. Varësisht nga përgjigjja e qeverisë përkatëse, Sekretariati mund t'ia paraqesë çështjen Këshillit të Ministrave të Komunitetit Energjetik për të marrë një vendim mbi harmonizimin e palës me Traktatin.

Më 13 korrik 2023, Sekretariati ia dorëzoi Këshillit Ministror një kërkesë të argumentuar për të marrë një vendim që konfirmonte mosrespektimin e Bosnjës dhe Hercegovinës, Kosovës dhe Maqedonisë së Veriut, gjë që e bëri në dhjetor 2023.¹⁶ Meqenëse shkeljet nuk janë korrigjuar, që nga maji 2025, çështja mbetet e hapur.¹⁷

Çështja kundër Serbisë mbetet e hapur, por nuk është ngritur në instancë më të lartë për shkak të paqartësive lidhur me ndikimet e investimeve aktuale në pajisjet e kontrollit të ndotjes.

Është alarmues fakti që të dhënat e përgjithshme të grumbulluara për vitin 2024, që i janë raportuar Agjencisë Evropiane të Mjedisit Jetësor¹⁸ nga Bosnja dhe Hercegovina, Kosova, Maqedonia e Veriut dhe Serbia tregojnë shkelje të vazhdueshme të emetimeve për të tre ndotësit e matur – SO₂, pluhur dhe NO_x.

Edhe pse emetimet absolute të dioksidit sulfurik u ulën deri diku në vitin 2024, shumica e emetimeve të lejuara nga NERP-të e vendeve u ul gjithashtu, kështu që **shkelja e përgjithshme ishte gjashtë herë më e lartë se sa lejohej** – krahasuar me vitin 2023 kur ishte 5,7 herë më e lartë.

¹² Aty ku ishte e mundur, kemi përdorur statistika të emetimeve të verifikuara nga Agjencia Evropiane e Mjedisit Jetësor për periudhën nga viti 2018 deri në vitin 2020, që lënë përshtypjen se disa të dhëna mund të jenë deri diku të ndryshme nga ato të paraqitura në raportet e mëparshme të Përmbajës ose Mbyll.

¹³ Shqipëria nuk ka në funksion termocentrale të mëdha me djegie të brendshme. Termocentrali 98 MW me naftë dhe gaz në Vlorë asnjëherë nuk ka operuar me kapacitet komercial për shkak të problemeve teknike.

¹⁴ Sekretariati i Komunitetit Energjetik, Rasti ECS 07/21, Maqedonia e Veriut/Mjedisit, Rasti ECS 08/21, Kosova*/Mjedisit, Rasti ECS 09/21, Bosnja dhe Hercegovina/Mjedisit, Rasti ECS 10/21, Serbia/Mjedisit, Komuniteti Energjetik, qasur më 26 korrik 2024.

¹⁵ Sekretariati i Komunitetit Energjetik, Sekretariati ngre padi kundër tre Palëve Kontraktuese për moszvogëlimin e ndotjes së ajrit nga termocentralet, Komuniteti Energjetik, 23 shkurt 2022.


¹⁶ Këshilli i Ministrorëve i Komunitetit Energjetik, Vendimi 2023/06/MC-EnC mbi mosrespektimin nga Bosnja dhe Hercegovina të Traktatit të Komunitetit Energjetik në Rastin ECS-9/21, Vendimi 2023/05/MC-EnC mbi dështimin e Kosovës* për të përmbushur Traktatin e Komunitetit Energjetik në Rastin ECS-8/21, Vendimi 2023/04/MC-EnC mbi mosrespektimin nga Republika e Maqedonisë së Veriut të Traktatit të Komunitetit Energjetik në Rastin ECS-7/21.

¹⁷ Sekretariati i Komunitetit Energjetik, Rasti ECS 09/21, Bosnja dhe Hercegovina/Mjedisit, Komuniteti Energjetik, qasur më 26 korrik 2024.

¹⁸ Shiko Baza Qendrore e të Dhënave EIONET nën vegzën e emrit të vendit > Detyrimet e Bashkimit Evropian > Raportimi mbi termocentralet me djegie të brendshme.

Figura 1: Emetimet e dioksidit sulfurik nga termocentralet me qymyr të Ballkanit Perëndimor, të përfshira në NERP, krahasuar me kufijtë e lejuar të emetimeve, 2018–2024

	2018	2019	2020	2021	2022	2023	2024
Emetime dioksid sulfurik	606 467	621 553	660 700	531 466	577 684	589 644	518 248
Vlera kufitare dioksid sulfurik	103 682	103 682	103 682	103 518 ¹⁹	103 518	103 518	87 126



Në vitin 2023, për herë të parë që nga skadimi i afatit LCPD, Kosova raportoi emetime më të ulëta të SO₂ se kufiri i saj i përcaktuar. Por ky indikator pozitiv humbi në peshë nga rritja e emetimeve në Serbi dhe u përmbys në vitin 2024 kur Kosova shkeli përsëri nivelin e saj të maksimal të SO₂.

Emetimet e pluhurit u ulën pak në vitin 2024, por ishin 1,9 herë më të larta se NERP-të e vendeve për shkak të uljes së kufijve maksimalë.

¹⁹ Kufiri i SO₂ i Kosovës ra pak në vitin 2021.

Figura 2: Emetimet e pluhurit nga termocentralet me qymyr të Ballkanit Perëndimor, të përfshira në NERP, krahasuar me kufijtë e lejuar të emetimeve, 2018–2024




Në vitin 2022, për herë të parë, emetimet totale të oksideve të azotit tejkaluan pak shumën totale të vlerave kufitare të vendeve – një shkelje e cila u rrit në gati 1,4 herë më shumë se totali i tyre në vitin 2024. Kjo ndodhi për shkak se nuk kishte investime në zvogëlimin e NO_x, niveli i kufijve vjetor për këtë ndotës nga viti në vit bëhej më strikt dhe emetimet absolute mbetën në nivele të larta. Kosova dhe Bosnja e Hercegovina ishin shkelësit kryesorë në terma relativë, megjithatë edhe Serbia gjithashtu tejkaloi kufirin e saj të NO_x në vitet 2023 dhe 2024.

²⁰ Kufiri i pluhurit në Kosovë pësoi ulje të vogël në vitin 2021.

Figura 3: Emetimet e oksideve të azotit nga termocentralet me qymyr të Ballkanit Perëndimor, të përfshira në NERP, krahasuar me kufijtë e lejuar të emetimeve, 2018–2024

	2018	2019	2020	2021	2022	2023	2024
Emetime oksidet e azotit	77 068	72 136	79 694	67 213	70 767	69 153	62 531
Vlera kufitare oksidet e azotit	107 353	97 226	87 100	76 768	66 641	48 344	46 378



Nga kjo më lartë supozohet se të dhënat e emetimeve janë të sakta. Megjithatë, shumë nga të dhënat e ofruara nga operatorët e termocentralit janë më shumë vlerësime sesa rezultat i monitorimit të vazhdueshëm. LCPD²¹ i detyron vendet të instalojnë dhe operojnë pajisje të vazhdueshme për monitorim të emetimeve, por deri më sot pothuajse gjysma e termocentraleve me qymyr në Ballkanin Perëndimor ose nuk kanë pajisje të tilla të instaluar, ose pajisjet ekzistuese nuk funksionojnë. Prandaj, të dhënat e emetimeve për të gjitha vendet bazohen të paktën pjesërisht në vlerësimet e nxjerra nga matjet një herë në muaj dhe ndonjëherë edhe matjet e kryera një herë në tre muaj.

Në vitin 2024, për herë të parë, termocentralet e qymyrit të NERP të Bosnjës dhe Hercegovinës ishin emetuesit më të lartë të SO₂ në rajon., me 212 840 tonë, ose 11,3 herë më shumë se sa kufiri i lejuar. Kjo është një rritje e konsiderueshme krahasuar me 181 807 tonë të emetuar në vitin 2023.

Pas saj vinte Serbia, me 205 925 tonë, ose 4,6 herë më shumë se sa vlera e lejuar. Emetimet e SO₂ të Serbisë u ulën krahasuar me vitin 2023, kur ato arritën në 296 011 tonë.

²¹ Neni 12 i [Direktivës për Termocentralet e Mëdha me Dëgjie të Brendshme](#)

Në terma absolutë, shkelësi i vjetër Ugljevik në Bosnjë e Hercegovinë ishte përsëri njësia me emetimin më të lartë të SO₂ në rajon në vitin 2024, me 112 943 tonë. Pavarësisht instalimit të një njësie desulfurizimi, SO₂ e saj u rrit krahasuar me vitin 2022, kur termocentrali emetoi 85 526 tonë, dhe vitin 2023, kur emetoi 97 189 tonë. Pajisjet e desulfurizimit nuk funksionuan rregullisht ndërmjet viteve 2022 dhe 2024, pavarësisht se testimet thuhet se përfunduan me sukses në gusht 2020²² dhe një leje operimi është marrë për de-SO_x në nëntor 2021.²³ Gjithnjë e më shumë po vihet në dyshim nëse ky projekt prej 85 milionë eurosh do të arrijë që termocentrali në Ugljevik të jetë në përputhje me kufijtë e SO₂ dhe me vlerat kufitare të Direktivës për Emetimet Industriale që duhet t'i arrijë deri në vitin 2027.

Nikola Tesla B në Serbi gjithashtu pati emetime absolute jashtëzakonisht të larta të SO₂ në vitin 2024 – 76 631 tonë, që përfaqëson vetëm një rënie modeste nga viti 2023, kur emetoi 92 260 tonë. Një njësi desulfurizimi është aktualisht në fazat e avancuara të instalimit²⁴ (shih pjesën për Serbinë), por përvoja me Ugljevik dhe Kostolac B (shih më poshtë) tregon se nuk ka garanci se do arrihet pajtueshmëria me standardin.

Megjithëse vlerat kufitare individuale të njësive nuk janë të detyrueshme – të tilla janë vetëm ato në nivel vendi – duke parë shkeljet e këtyre vlerave në nivel njësie, në sipërfaqe dalin tregues të mirë se ku nevojiten intervenime të veçanta.

Në vitin 2024, së paku gjashtë njësi i tejkaluan kufijtë e tyre për emetimet e dioksidit të sulfurit me më shumë se dhjetë herë:

- Ugljevik, Bosnjë dhe Hercegovinë: 14 herë
- Kostolac A2, Serbi: 13,2 herë
- Tuzla 6, Bosnjë dhe Hercegovinë: 11,9 herë
- Gacko, Bosnjë dhe Hercegovinë: 11,7 herë
- Kakanj 7, Bosnjë dhe Hercegovinë: 11,7 herë
- Bitola B 1 dhe 2, Maqedonia e Veriut: 11,4 herë

Kostolac B, një nga emetuesit më të lartë absolut dhe relativ të dioksidit sulfurik nga viti 2018 deri në vitin 2020, më në fund filloi të ulë emetimet e tij në vitin 2024, por përsëri emetoi 2,3 herë më shumë se sa lejohej, ose 15 218 tonë. Pavarësisht se kishte instaluar një njësi desulfurizimi, pas një rënieje në vitin 2021, emetimet e saj të SO₂ u rritën në vitet 2022 dhe 2023. Termocentrali me de-SO_x të instaluar nga Korporata e Inxhinierisë së Makinerisë Kineze (CMEC), u inaugurua zyrtarisht në vitin 2017, por mori leje operimi tek në janar të vitit 2023.²⁵

Për sa i përket pluhurit, emetuesi absolut më i lartë në rajon ishte Gacko në Bosnjë dhe Hercegovinë. Ai emetoi 3 339 tonë – 13,7 herë më shumë se sa lejohet në NERP të BiH-së. Kjo përbënte vlerë më të madhe se në vitin 2023, kur emetoi 3 241 tonë, por prapëseprapë më e ulët se në vitin 2022 (3 649 tonë).

Emetues të tjerë shumë të lartë të pluhurit në rajon janë njësia Kosova B1, e cila emetoi 2 635 tonë në vitin 2024, ose 6.4 herë më shumë se sa lejohet, dhe Kosova B2, e cila emetoi 2 304 tonë, ose 5,6 herë më shumë se sa lejohet.

Për oksidet e azotit, Nikola Tesla B në Serbi pati deri tani emetimet më të larta absolute në vitin 2024, me 12 418 tonë – edhe më të larta se emetimet e vitit 2023 prej 11 633 tonësh.

²² RiTE Ugljevik, 'Izuzetni rezultati u zaštiti životne sredine', RiTE Ugljevik, 27 gusht 2020.

²³ Ministria e Planifikimit Hapësinor, Ndërtimeve dhe Ekologjisë e Republikës Srpska, Vendimi nr. 15.03-360-164/21.

²⁴ Shoqëria Aksionare Elektroprivreda Srbije, Raporti Mjedisor 2024, JSC EPS, Mars 2025, 83.

²⁵ Instituti Rregullator i Energjisë së Rinovueshme dhe Mjedisit (RERI), Desulfurizimi në Ballkanin Perëndimor, Instituti Rregullator i Energjisë së Rinovueshme dhe Mjedisit (RERI), Mars 2023.

Në terma relativë, Kosova A5 ishte shkelësi më i keq i standardit për oksidet e azotit në vitin 2024, duke emetuar 3,9 herë më shumë se sa lejohet, ose 2 472 tonë.

Të tre vendet me termocentrale që hynë në regjimin e afatizuar për ndalim funksionimi, tani janë gjithashtu duke shkelur LCPD.

Në vitin 2018 tetë njësi në Bosnjë e Hercegovinë, Mal të Zi dhe Serbi hynë në të ashtuquajturin regjim 'opt-out': Tuzla 3 dhe 4, Kakanj 5, Pljevlja, Morava, Kolubara A3 (Ngrohtorja 1), Kolubara A3 (Ngrohtorja 3, 4, 5) dhe Kolubara A5.²⁶ Por asnjëri prej tyre nuk ka respektuar ELV-të përkatëse, pavarësisht se afati i 31 dhjetorit 2023 ka kaluar shumë kohë më parë dhe shumica ose të gjitha kanë tejkaluar kufijtë e tyre prej 20 000 orësh pune. Në vitin 2024, vetëm Tuzla 3 nuk kishte orë të raportuara operimi, por as ajo nuk është mbyllur zyrtarisht (shih pjesën për Bosnjën dhe Hercegovinën).

Termocentrali i Pljevljes në Mal të Zi po i nënshtrohet një rikonstruksioni, dhe afati i operimit i Tuzla 4 dhe Kakanj 5 në Bosnjë dhe Hercegovinë u zgjat në mënyrë të jashtëligjshme me një vendim të Parlamentit të Federatës së BiH në mars 2022.²⁷ Në fillim të vitit 2023, Elektroprivreda Srbije (EPS) njoftoi se do t'i mbyllte termocentralet Kolubara dhe Morava në fund të vitit 2024,²⁸ por kjo nuk ndodhi dhe në strategjinë e energjisë së vendit tani përmendet viti 2030 si periudhë (shih pjesën për Serbinë).

Për shkak të shkeljeve të dispozitave të regjimit të përjashtimit nga funksionimi, Sekretariati i Komunitetit Energjetik ngrii raste për konteste kundër Malit të Zi në prill 2021²⁹ Bosnjës dhe Hercegovinës në tetor 2022,³⁰ dhe Serbisë në tetor 2023.³¹

Në përgjithësi, shtatë vjet pas kalimit të afatit të harmonizimit me LCPD në Komunitetin Energjetik, situata mbetet brengosëse. Që nga viti 2018, emetimet e dioksidit sulfurik dhe oksidet e azotit të parapara në NERP mezi janë ulur, madje emetimet e pluhurit kanë shënuar rritje. Asnjë nga termocentralet e planifikuara nuk është mbyllur. Dhe megjithatë, asnjë operator i termocentralit nuk është gjobitur për këto shkelje flagrante.

²⁶ Sekretariati i Komunitetit Energjetik, [Raporti Përmbledhës i Sekretariatit të Komunitetit Energjetik mbi listën përfundimtare të termocentraleve të përjashtuara, Komuniteti Energjetik, Prill 2018.](#)

²⁷ Sekretariati i Komunitetit Energjetik, ["Shqetësimet mjedisore rriten me vendimin për zgjatjen e funksionimit të Tuzla 4 dhe Kakanj 5", Komuniteti Energjetik, 25 mars 2022.](#)

²⁸ Vladimir Spasić, 'EPS përcakton planin për mbylljen e termocentraleve me qymyr', [Lajme për Energjinë e Gjellbër në Ballkan, 16 shkurt 2023.](#)

²⁹ Sekretariati i Komunitetit Energjetik, ["Rasti ECS-15/21: Mali i Zi / Mjedisë", Komuniteti Energjetik, qasur më 19 maj 2025.](#)

³⁰ Sekretariati i Komunitetit Energjetik, ["Sekretariati nis procedurën e kontesteve kundër Bosnjës dhe Hercegovinës për shkelje të Direktivës për Termocentrale të Mëdha me Djegie të Brendshme në rastin e Tuzla 4 dhe Kakanj 5".](#)

³¹ Sekretariati i Komunitetit Energjetik, ["Sekretariati nis procedurën e kontesteve kundër Serbisë për shkelje të Direktivës së Termocentraleve të Mëdha me Djegie të Brendshme në rastin e TC Morava".](#)

Termocentrali i Kosova A, Kosovë

Foto: Matteo Trevisan, realizuar si pjesë e projektit fotografik me titull "Më i nevojshëm se dielli"



CBAM po vjen, megjithatë asnjë shtet nuk ka ndonjë plan të qartë

Qeveritë dhe komunat në Ballkanin Perëndimor për vite me radhë e kanë paraqitur qymyrin si një burim të besueshëm energjetik të brendshëm, por kjo pikëpamje tani është e vjetëruar dhe në kundërshtim me realitetin. Që nga viti 2025, moshë mesatare e njësive të energjisë me qymyr në rajon është 48 vjet. Komunat po përpiqen t'ua shtrydhin çdo pikë të fundit të jetës përmes rikonstruksioneve të kushtueshme, si ai prej 137 milionë eurosh i paralajmëruar për termocentralin Kosova A3 në janar 2025 ose ai prej 80 milionë eurosh që është duke u zhvilluar në Pljevlja në Mal të Zi, por nuk është e qartë nëse do të kenë sukses. Ndërprerjet e planifikuara dhe të paplanifikuara në termocentralet e qymyrit janë gjithnjë e më të zakonshme.

Viteve të fundit, furnizimi me qymyr ka qenë një problem i madh për Maqedoninë e Veriut dhe Serbinë, duke i detyruar ato të drejtohen drejt importeve të kushtueshme. Në dimrin e viteve 2024 dhe 2025, termocentrali i Ugljevikut në Bosnjë dhe Hercegovinë u mbyll dy herë për shkak të mungesës së qymyrit, pavarësisht se kishte minierë të izoluar, dhe prodhimi i qymyrit thuhet se u përgjysmua në Federatën e BiH ndërmjet viteve 2018 dhe 2023.³²

I kombinuar me faktorë të tjerë, siç janë mbështetja e madhe në energjinë e prodhuar nga hidrocentralet të cilat ndikojnë në klimë, çmimet e larta të gazit që përkthehen në çmime të larta të importit të energjisë dhe zhvillimi relativisht i vonë dhe i ngadaltë i projekteve të energjisë së erës dhe asaj diellore, furnizimi me energji i Ballkanit Perëndimor është nën presion. Kjo është përdorur si justifikim nga komunat dhe qeveritë për të zgjatur në mënyrë të paligjshme afatin e funksionimit të njësive Tuzla 4 dhe Kakanj 5 në Bosnjë dhe Hercegovinë dhe për të vazhduar me funksionimin e termocentraleve Morava dhe Kolubara në Serbi dhe termocentralit Pljevlja në Mal të Zi. Krizat e menjëhershme që goditën disa nga vendet nga viti 2021 deri në vitin 2023 janë zbutur për momentin, por për sa kohë, kjo mbetet e paqartë.

Nga njëra anë, është bërë progres në instalimet e energjisë me erë dhe solare: në vitet 2023 dhe 2024 pati një përshpejtim të përhapjes së energjisë solare, veçanërisht në Maqedoninë e Veriut, e cila arriti pothuajse 850 MW kapacitet të instalimeve solare deri në fund të vitit 2024, duke kontribuar me 14 përqind të prodhimit vendore të energjisë elektrike.³³ Kjo, së bashku me një rënie të lehtë të kërkesës, i mundësoi vendit t'i ulë importet neto vjetore të energjisë elektrike nga një mesatare prej 20-30 përqind të konsumit në vetëm 2,75 përqind në vitin 2023.³⁴ Megjithatë, kjo shifër u rrit përsëri në 11 përqind në vitin 2024; arsytet për këtë janë të paqarta.³⁵ Qymyri përbënte ende 38 përqind të prodhimit vendor të energjisë në vitin 2024 – megjithatë, sipas NECP-së aktuale, vendi duhet ta heqë atë gradualisht nga përdorimi deri në vitin 2027, ose më së voni në vitin 2029.³⁶

Bosnja dhe Hercegovina dhe Mali i Zi zakonisht janë eksportues neto të energjisë elektrike, por në tremujorin e parë të vitit 2025, BiH u bë importuese neto e saj³⁷ për herë të parë në dekada. Me termocentralin e Pljevljes jashtë funksionit për shtatë muaj e gjysmë duke filluar nga fundi i marsit 2025, Mali i Zi do të duhet të importojë edhe për një periudhë të caktuar.

E gjithë kjo ndodhë pa qenë ende në fuqi Mekanizmi i Rregullimit të Kufirit të Karbonit (CBAM) i BE-së. Që nga fillimi i vitit 2026, perspektiva ekonomike e qymyrit në Ballkanin Perëndimor do të jetë edhe më e keqe, pasi eksportet e energjisë elektrike në BE do t'i nënshtrohen tarifave CBAM bazuar në intensitetin e karbonit të përzjerjes së tyre të energjisë elektrike. Ndikimet e kësaj nuk varen nga vendet që janë eksportuese neto, por nga sasia e energjisë elektrike që ato eksportojnë në përgjithësi dhe pjesa e saj në përzjerjen e tyre të energjisë elektrike.

Për këtë arsye, Bosnja dhe Hercegovina, Mali i Zi dhe Maqedonia e Veriut pritet të jenë më të prekurat. Dy të parat kanë eksporte më të ulëta se zakonisht për momentin, por ato ende ekzistojnë dhe nëse rindërtimi i Pljevljes shkon sipas planit dhe viti 2025 ka reshje të mjaftueshme, të dy vendet pritet të bëhen përsëri eksportuese neto. Nga ana tjetër, Maqedonia e Veriut nuk është një eksportues neto, por kufizohet nga dy vende të BE-së dhe tregton një pjesë të konsiderueshme të prodhimit të saj me to.³⁸

³² Ermin Zatega, 'Kako je Bosna i Hercegovinës postala ovisna o uvoznjoj električnoj energiji?', *Radio Slobodna Evropa*, 1 maj 2025.

³³ Komisioni Rregullator i Shërbimeve Komunale të Energjisë, Ujit dhe Menaxhimit të Mbeturinave i Republikës së Maqedonisë së Veriut (ERC), *Raporti Vjetor 2024*, ERC, Prill 2025.

³⁴ ERC, *Raporti Vjetor 2023*, ERC, Prill 2024.

³⁵ ERC, *Raporti Vjetor 2024*, ERC, Prill 2025.

³⁶ Versioni përfundimtar përmban një paragraf shtesë me një mundësi për të zgjatur afatin deri në vitin 2029. Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut, *Plani Kombëtar i Energjisë dhe Klimës i Republikës së Maqedonisë së Veriut, Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut*, 31 maj 2022.

³⁷ Ermin Zatega, 'Kako je Bosna i Hercegovinës postala ovisna o uvoznjoj električnoj energiji?',

³⁸ Për më shumë detaje, shih Ioana Ciuta dhe Pippa Gallop, *Sektori i Energjisë në Ballkanin Perëndimor – Midis krizës dhe tranzicionit*, CEE Bankwatch Network, dhjetor 2022.

Meqenëse çmimet e energjisë elektrike për familjet rregullohen me çmime më të ulëta se kostoja në Ballkanin Perëndimor, kompanitë e shërbimeve varen nga eksportet me çmime më të larta për të ardhurat e tyre, dhe çdo rënie e eksporteve do t'i godasë ato ndjeshëm.

Asnjë nga vendet nuk mund të arsyetohet se nuk e kanë parashikuar CBAM-in, pasi kjo është diskutuar në nivelin e BE-së të paktën që kur u njoftua Pakti i Gjelbër Evropian në dhjetor 2019. Ato mund të ishin përjashtuar nga eksportet e tyre të energjisë elektrike që i nënshtrohen tarifave CBAM nëse do t'i kishin lidhur tregjet e tyre të energjisë elektrike me ato të BE-së, do të kishin futur çmimet e karbonit në nivelin e Sistemit të Tregtimit të Emetimeve të BE-së dhe do t'i kishin përmbushur disa kushte të tjera, por progresi ka qenë i ngadaltë.

Pavarësisht kësaj stuhie që po përgatitet, asnjë nga vendet nuk ka plan të qartë dhe të realizueshëm se si ta përballojë atë.

Deri në fund të qershorit të vitit 2023 të gjitha qeveritë e Ballkanit Perëndimor duhej të dorëzonin draft-Planet e tyre Kombëtare Energjetike dhe Klimatike (NECP) në Sekretariatit e Komunitetit Energjetik dhe planet e tyre përfundimtare deri në fund të qershorit 2024. Me NECP vendet përkatëse duhej përfundimisht të kenë qartësuar planet që termocentralet e tyre të qymyrit të ishin të harmonizuara ose të mbylleshin, por vetëm Maqedonia e Veriut dhe Shqipëria kishin miratuar NECP shumë kohë para afatit, dhe këto duhet të përditësohen për të pasqyruar objektivat e Komunitetit Energjetik 2030, si dhe situatën në terren.

NECP i parë i Maqedonisë së Veriut³⁹ përcaktoi heqjen graduale të qymyrit nga përdorimi në vend për vitin 2027, me një mundësi për ta zgjatur këtë deri në vitin 2029.⁴⁰ Përditësimi i draftit të NECP-së nga viti 2025 e zhvendos datën e heqjes graduale të qymyrit në vitin 2030. Sipas draftit, Oslomej duhet të çaktivizohet në vitin 2026, një vonesë prej shtatë vitesh krahasuar me strategjinë energjetike të vendit, dhe Bitola (Manastiri) do të mbyllë nga një njësi çdo vit në periudhën midis viteve 2028 dhe 2030. Një nga njësitë e Bitolës është planifikuar të zëvendësohet me një termocentral gazi me kombinim të nxehtësisë dhe energjisë (CHP) prej 200 MW në vitin 2028: duke marrë parasysh kohën e lejeve dhe të ndërtimit, si dhe disponueshmërinë aktuale të infrastrukturës së transportit të gazit, kjo duket goxha e pamundur. Kjo gjithashtu do të rezultonte në një bllokim të ri të karburanteve fosile dhe varësi nga gazi i importuar dhe i kushtueshëm.

Në korrik 2024, Serbia miratoi gjithashtu një NECP përfundimtar,⁴¹ por ky dokument nuk është aspak i qartë për mënyrën se si do të ndodhë heqja graduale e qymyrit. Vendi është gjithashtu shumë i papërgatitur për një tranzicion të drejtë të komuniteteve të tij që varen nga qymyri.

Bosnja dhe Hercegovina dhe Kosova dorëzuan draftet e NECP-ve në qershor dhe korrik 2023, por që nga mesi i majit 2025 nuk i kishin miratuar ende ato. Draftet përshkruanin disa hapa që duheshin ndërmarrë para vitit 2030 në lidhje me termocentralet me qymyr, duke lënë disa detaje të paqarta. Asnjëra prej tyre nuk përmendi datat e heqjes graduale të qymyrit nga përdorimi më herët se afati i përgjithshëm i BE-së për neutralitet karboni në vitin 2050.

Mali i Zi i dorëzoi një draft të NECP-së Sekretariatit të Komunitetit Energjetik tek në dhjetor 2024,⁴² dhe që nga maji i vitit 2025 as nuk e ka publikuar për konsultim publik. Vendi më parë ishte zotuar për një datë të heqjes graduale të qymyrit në vitin 2035,⁴³ por drafti i NECP-së përmend një sërë datash, duke përfshirë vitet 2035 dhe 2040. Megjithatë, realiteti ekonomik ka të ngjarë ta detyrojë mbylljen para kësaj kohe, dhe zhvillimi aktual i energjisë nga era dhe solare në vend është shumë i ngadaltë për ta zëvendësuar kapacitetin ekzistues.

Të gjitha çështjet me të cilat përballlet sektori i qymyrit në Ballkanin Perëndimor duhet të trajtohen në një mënyrë koherente, por kjo kërkon një kuptim të mirë të peizazhit politik dhe ekonomik të BE-së në lidhje me energjinë, si dhe vullnet dhe guxim politik, të cilat mungojnë shumë në mesin e qeverive në rajon, të cilat në vend të kësaj po kapen pas planeve të kushtueshme dhe të vjetruara, siç janë gazifikimi dhe desulfurizimi.

Gazifikimi do të ishte një gabim i madh dhe shumë i kushtueshëm për një rajon që është shumë më pak i varur nga gazi fosil sesa BE-ja, dhe kërcënon të shkapësjë vëmendjen nga teknologjitë më relevante dhe të qëndrueshme ndaj së ardhmes, siç janë energjia diellore dhe e erës, pompat e nxehtësisë dhe energjia gjeotermale.⁴⁴

Desulfurizimi dhe pajisjet për uljen e emetimeve të oksideve të azotit mund të kishin kuptim nëse puna do të kishte filluar seriozisht kur Traktati i Komunitetit Energjetik hyri në fuqi në vitin 2006, por periudha kur do të mund të arrihej pajtueshmëria ligjore vetë ka kaluar prej kohësh. Ose qeveritë duhet të bëjnë plane për mbyllje të kontrolluar dhe një tranzicion të drejtë të komuniteteve të qymyrit që tani, ose një mbyllje e pakontrolluar do të ndodhë vetë.

³⁹ Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut, [Plani Kombëtar i Energjisë dhe Klimës i Republikës së Maqedonisë së Veriut](#), Projektligj, Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut, korrik 2020.

⁴⁰ Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut, [Plani Kombëtar i Energjisë dhe Klimës i Republikës së Maqedonisë së Veriut](#).

⁴¹ Qeveria e Serbisë, [Integrisani nacionalni energetski i klimatski plan republike Srbije za period do 2030. sa vizijom do 2050. Godine](#), Ministria e Minierave dhe Energjisë e Republikës së Serbisë, 1 gusht 2024.

⁴² Sekretariati i Komunitetit Energjetik, [Qeverisja dhe Planet Kombëtare të Energjisë dhe Klimës – Mali i Zi harton Planin Kombëtar të Energjisë Kombëtare \(NECP\)](#), Komuniteti Energjetik, dorëzuar më 9 dhjetor 2024.

⁴³ Përtej Lëndëve Djegëse Fosile, [Heqja dorë nga qymyri në Evropë - Përmbledhje e zotimeve kombëtare për heqjen graduale të qymyrit](#), Përtej Lëndëve Djegëse Fosile, përditësuar për herë të fundit më 10 qershor 2024.

⁴⁴ Me kapjen e çdo gazi të dëmshëm dhe riinjektimin e ujit

Profilet e shteteve

Bosnja dhe Hercegovina (BiH)

Harmonizimi me vlerat kufitare të NERP në vitin 2024

NERP i Bosnjës dhe Hercegovinës⁴⁵ mbulon shtatë njësi me qymyr⁴⁶ dhe një termocentral më të vogël industrial që përdor naftë industriale. Nga këto, dy njësi, Gacko dhe Ugljevik, gjenden në Republikën Srpska, dhe termocentralet e Tuzlës dhe Kakanjit – të cilat secila kanë nga dy njësi në NERP – janë në Federatën e Bosnjës dhe Hercegovinës (FBiH).

Tre njësi të tjera – Tuzla 3, Tuzla 4 dhe Kakanj 5⁴⁷ – iu nënshtroan afatizimeve për funksionim ('regjimi opt-out') (shih pjesën më poshtë).

BiH ka gjithashtu një termocentral më të ri i cili nuk kualifikohet për përfshirje në NERP – Stanari, në Republikën Srpska, i cili zyrtarisht filloi punën në shtator 2016 dhe ishte i detyruar të përmbushte vlerat kufitare të LCPD për termocentralet e reja sapo filloi funksionimin.

Edhe një herë në vitin 2024, termocentralet e qymyrit të Bosnjës dhe Hercegovinës, të përfshira në NERP, nuk i përmbushën kufijtë për asnjë nga ndotësit e kërkuar: dioksidin e sulfurit, pluhurin ose oksidet e azotit.


Në fakt, në vitin 2024, **emetimet e dioksidit të sulfurit nga termocentralet e përfshira në NERP në BiH u rritën ndjeshëm** krahasuar me vitin pararendës. Ato u rritën më tepër se njëmbëdhjetë herë më shumë se sa lejohej – 212 840 tonë, krahasuar me kufirin prej 18 862 tonësh. Në vitin 2023, njësitë e përfshira në NERP emetuan 181 807 tonë SO₂, ose 8,2 herë më shumë se sa lejohej. Edhe pse kufiri i lejuar i SO₂ në BiH ishte pak më i ulët në vitin 2024 krahasuar me vitin 2023, pjesa më e madhe e përqekësimit është shkaktuar nga emetimet më të larta absolute dhe jo nga kufiri më i ulët.

⁴⁵ USAID, *Draft Plani Kombëtar i Reduktimit të Emetimeve për Bosnjën dhe Hercegovinën*, Komuniteti Energjetik, nëntor 2015.

⁴⁶ Teksti i NERP përfshin gjithashtu Kakanj 5 dhe Tuzla 4, por këto u miratuan më vonë si termocentrale me regjim 'opt-out', kështu që kufijtë realë për BiH nuk përfshijnë kontributet e këtyre termocentraleve.

⁴⁷ Sekretariati i Komunitetit Energjetik, *Raport mbi listën përfundimtare të termocentraleve të përfshirura*.


Figura 4: Emetimet e dioksidit sulfurik nga termocentralet e qymyrit të Bosnjës e Hercegovinës, të përfshira në NERP, krahasuar me kufijtë e lejuar të emetimeve, 2018–2024



Shkelësi më i keq në BiH dhe në rajon në vitin 2024 për sa i përket emetimeve absolute ishte përsëri Ugljevik, ku ishte shumë e qartë që pajisja e desulfurizimit nuk funksiononte, pavarësisht se kishte marrë leje operimi në nëntor 2021.⁴⁸ **Emetimet e saj për vitin 2024 prej 112 943 tonësh ishin në nivelin e tyre më të lartë që nga hyrja në fuqi e LCPD në vitin 2018.**

⁴⁸ Ministria e Planifikimit Hapësinor, Ndërtimeve dhe Ekologjisë e Republikës Srpska, Vendimi nr. 15.03-360-164/21.


Figura 5: Emetimet e dioksidit sulfurik nga Ugljevik, krahasuar me vlerën kufitare individuale të emetimeve, 2018–2024



Në vitin 2024, Ugljevik pati gjithashtu tejkalimin më të lartë të dioksidit të sulfurit në Bosnjë dhe Hercegovinë – 14 herë më shumë se sa lejohet. Por Gacko, Kakanj 7 dhe Tuzla 6 gjithashtu emetuan më tepër se 11,5 herë më shumë SO₂ se sa lejohet.

Në vitin 2024, emetimet e pluhurit nga termocentralet e përfshira në NERP të Bosnjës dhe Hercegovinës arritën në 4 146 tonë. Kjo ishte pak më pak se në vitin 2023 (4 647 ton) dhe përfaqësonte një rënie nga piku i vitit 2021 prej 6 040 tonësh, por ishte ende shumë më tepër se 2 686 tonë të emetuar në vitin 2020. Edhe pse emetimet absolute u ulën pak në vitin 2024, kështu ndodhi edhe me kufirin e lejuar për emetimet, kështu që tejkalimi i përgjithshëm ishte më i lartë (3,1 herë më shumë se sa lejohej) krahasuar me vitin e kaluar (2,8 herë).

Figura 6: Emetimet e pluhurit nga termocentralet me qymyr të Bosnjës e Hercegovinës, të përfshira në NERP, krahasuar me kufijtë e lejuar të emetimeve, 2018–2024




Deri tani, fajtori kryesor ishte termocentrali Gacko, emetimet e pluhurit të së cilit arritën në 13,7 herë më shumë se sa lejohej në vitin 2024. Pasi banorët nga zona e Nadiniçit mbajtën një protestë për shkak të ndotjes në maj 2023,⁴⁹ duket se më në fund po bëheshin disa përpjekje për ta zgjidhur problemin. Deri në tetor 2023, u panë disa përmirësime. Megjithatë, u paralajmërua gjithashtu se kjo ishte një zgjidhje e përkohshme dhe se do të nevojiteshin investime të mëtejshme.⁵⁰ Matjet e vitit 2024 tregojnë se në përgjithësi, situata është përmirësuar shumë pak.

⁴⁹ Kroz Staru Hercegovinu, 'RiTE Gacko: Saopštenje za javnost', Kroz Staru Hercegovinu, 16 maj 2023.

⁵⁰ Radio Televizija Republike Srpske, 'Gacko: Privremeno riješen problem zagađenja vazduha', RTRS Vijesti, 28 tetor 2023.

Figura 7: Emetimet e pluhurit nga termocentrali Gacko, krahasuar me vlerën kufitare individuale të emetimeve, 2018–2024




Emetimet e oksideve të azotit nga termocentralet e qymyrit të përfshira në NERP të BiH në vitin 2024 arritën në total 11 632, krahasuar me kufirin e lejuar prej 6 867 tonësh. Kjo ishte pothuajse e njëjtë me atë të vitit 2023 (11 752 tonë).

Megjithatë, tejkallimet e kufirit të NO_x në BiH janë duke u rritur vazhdimisht, sepse kufiri i NERP për NO_x bie vazhdimisht çdo vit. Në vitin 2024, emetimet e NO_x ishin 1,7 herë më të larta se kufiri – pak më të larta se në vitin 2023 kur ishin 1,6 herë më të larta.

Në vitin 2024, Gacko pati tejkallimin më të lartë të kufirit për NO_x, me 2,6 herë më shumë se sa lejohet. Emetimet e NO_x të Kakanj 7 ishin gjithashtu pak më shumë se dyfishi i lejuar.

Figura 8: Emetimet e oksidit të azotit nga termocentralet me qymyr të Bosnjës e Hercegovinës, të përfshira në NERP, krahasuar me kufijtë e lejuar të emetimeve, 2018–2024



Bosnja dhe Hercegovina (2024)

Vlera kufitare e SO ₂ ⁵¹	Emetimet e SO ₂	Vlera kufitare e pluhurit	Emetimet e pluhurit	Vlera kufitare e NO _x	Emetimet e NO _x
18 862	212 840	1 333	4 146	6 867	11 632

Në mars të vitit 2021, për shkak të shkeljeve të vlerave kufitare të përcaktuara në NERP, Sekretariati i Komunitetit Energjetik hapi një kontest kundër Bosnjës e Hercegovinës, së bashku me rastet kundër vendeve të tjera. Më 13 korrik 2023, Sekretariati i paraqiti Këshillit të Ministrave një kërkesë me sqarime për të marrë një vendim që konfirmonte mosharmonizimin e kryer, gjë që Këshilli e bëri në dhjetor të vitit 2023.⁵² Meqenëse shkeljet nuk janë korrigjuar, që nga maji 2025, çështja mbetet e hapur.⁵³

Në përgjithësi në Bosnjë dhe Hercegovinë, që nga viti 2018 emetimet e dioksidit sulfurik dhe pluhurit nga termocentralet e përfshira në NERP janë rritur, ndërsa vetëm emetimet e oksidit të azotit shënojnë ulje, pavarësisht mungesës së investimeve në pajisjet e denitrifikimit.

⁵¹ Kufijtë fillestarë të BiH në NERP përfshinin Kakanj 5 dhe Tuzla 4, të cilët më vonë u përfshinë në regjimin e përjashtimit, kështu që llogaritjet për kufirin u bazuan në shumën e kufijve për termocentralet e tjera.

⁵² Këshilli i Ministrorëve i Komunitetit Energjetik, [Vendimi 2023/06/MC-EnC mbi mosrespektimin nga Bosnja dhe Hercegovina të Traktatit të Komunitetit Energjetik në Rastin ECS-9/21](#).

⁵³ Sekretariati i Komunitetit Energjetik, [Rasti ECS 09/21, Bosnja dhe Hercegovina/ Mjedisi](#).

'Përrjashtimi' nga harmonizimi

Siç u përmend më lart, Tuzla 3, Tuzla 4 dhe Kakanj ⁵⁴ nënshtruan të ashtuquajturit regjim 'opt-out', i cili u mundësoi tre termocentraleve të funksionojnë për një total prej 20 000 orësh ndërmjet 1 janarit 2018 dhe 31 dhjetorit 2023. Pas kësaj, ata ose duhej të mbyllen ose të harmonizohen me vlerat kufitare të emetimeve për termocentralet e reja, sipas Direktivës së Emetimeve Industriale.

Që nga 1 janari 2018 deri në fund të vitit 2023, Tuzla 3 kishte harxhuar 19 476 orë, por për shkak të skadimit të afatit, edhe ashtu duhej të mbyllej. ⁵⁵ Nuk është e qartë nëse kjo ka ndodhur, pasi nuk është marrë asnjë vendim që të vazhdojë me punë, por nuk ka as njoftime për mbyllje. Ekzistojnë plane të diskutueshme për zëvendësimin e tij me një termocentral që operon me biomasë, por ende nuk është e qartë nëse dhe kur do të fillojë. ⁵⁶

Siç është paraqitur në raportet e mëparshme Përmbaju ose Mbyll, ⁵⁷ Tuzla 4 dhe Kakanj 5 kanë vazhduar të punojnë pas datës së tyre ligjore të skadencës. Pasi të kenë shfrytëzuar 20 000 orët e tyre, ato mund të operojnë vetëm nëse plotësojnë vlerat kufitare të emetimeve, të përcaktuara në Pjesën 2 të Aneksit V të Direktivës 2010/75/BE. ⁵⁸ Askund në dokumentacionin e ofruar nga operatori i termocentralit, Elektroprivreda Bosne i Hercegovine (EPBiH), dërguar qeverisë apo në dokumentacionin e ofruar nga qeveria parlamentit të FBeH, nuk sugjerohet se janë planifikuar investime që do ta mundësonin një harmonizim të tillë.

NNë tetor të vitit 2022, Sekretariati i Komunitetit Energjetik ngriti një rast të dytë kundër Bosnjës e Hercegovinës për mospërputhje me Direktivën për Termocentralet e Mëdha me Djegie të Brendshme. ⁵⁹

Investimet aktuale për kontrollin e ndotjes

Në vitin 2024, i vetmi zhvillim i rëndësishëm në lidhje me kontrollin e ndotjes ishte nënshkrimi i një kontrate me Dongfang Electric International Corporation nga Kina, ITC nga Zenica, State Power Investment Group Yuanda Environmental Protection Engineering Co. Ltd. nga Kina, Saraj Inženjering nga Sarajeva, Winner nga Sarajeva dhe Firing nga Visoko për ndërtimin e një njësie desulfurizimi për njësitë 6 dhe 7 të Kakanj. Parashikohet të kushtojë pak më pak se 63 milionë euro – dukshëm më pak se 85 milionë eurot e nevojshme për Ugljevik, edhe pa marrë parasysh inflacionin – dhe duhet të përfundojë brenda 26 muajsh. ⁶⁰ Megjithatë, bazuar në progresin e ngadaltë që po bën një konsorcium i udhëhequr nga Dongfang në rehabilitimin e termocentralit Pljevlja të Malit të Zi dhe rritjet e çmimeve që lidhen me projektin (shih pjesën për Malin e Zi), kjo mund të mos jetë kostoja ose afati përfundimtar.

Në njoftimin për shtyp që njoftonte marrëveshjen e desulfurizimit të Kakanjit, Elektroprivreda BiH njoftoi gjithashtu se një tender për desulfurizimin e njësisë 6 të termocentralit të Tuzlës është në vazhdim e sipër, por që nga fillimi i majit 2025 nuk duket se është përfunduar.

Plani më i fundit i biznesit i EPBiH ⁶¹ pret që kompania të investojë në 'rindërtimin' e Kakanj 7; desulfurizimin dhe denitrifikimin në Kakanj dhe Tuzla; dhe 'rivializimin' e Tuzla 4, i cili është tashmë 54 vjeç dhe duhet të ishte mbyllur sipas sistemit të përjashtimit. Së bashku me disa projekte më të vogla, këto vlerësohet të kushtojnë një total prej 528 milionë BAM, ose rreth 264 milionë euro, shumica e të cilave duhet të vijnë nga fondet e vetë kompanisë. ⁶² Duke pasur parasysh gjendjen e dobët financiare të kompanisë ⁶³ dhe ndikimet e pritura të mekanizmit të BE-së për rregullimin e kufijve të karbonit (CBAM), i cili do të fillojë në vitin 2026, kjo duket të jetë zgjidhje optimiste.

Bosnja dhe Hercegovina deri më tani nuk ka dalë me një plan të qartë për të hequr gradualisht qymyrin nga përdorimi. Parashikimet zyrtare ⁶⁴ që disa nga termocentralet e përfshira në NERP do të funksionojnë përtej vitit 2030 nuk janë realiste. Edhe duke llogaritur termocentralin më të ri Stanari që u hap në vitin 2016, termocentralet e qymyrit në BiH janë mesatarisht 45 vjeç. Termocentralet e përfshira në NERP kanë një mesatare pak më të ulët prej 43 vitesh, por vetëm Ugljevik ka pajisje desulfurizimi, dhe as ato nuk po përdoren. Pra, është e vështirë të imagjinohet se instalimi i de-SO_x në termocentralet e mbetura ka kuptim, qoftë ekonomikisht apo edhe në aspektin mjedisor, duke marrë parasysh mangësitë e vendit në sundimin e ligjit. Por vazhdimi me nivelet aktuale të ndotjes është jashtëzakonisht i dëmshëm për shëndetin e njeriut, si dhe i paligjshëm, kështu që duhet të gjenden zgjidhje të përkohshme para mbylljes.

⁵⁴ Sekretariati i Komunitetit Energjetik, [Raport mbi listën përfundimtare të termocentraleve të përjashtuara](#).

⁵⁵ Plani i Biznesit i Elektroprivreda BiH 2025-2027 nuk e përmend njësinë. Shih Elektroprivreda BiH, [Plan poslovanja za period 2025.-2027. godina, Elektroprivreda BiH, 10 dhjetor 2024](#). Nga ana tjetër, Plani Tregues i Zhvillimit të Gjenerimit i Operatorit të Sistemit të Pavarur 2025 deri në 2034 thotë se ka qenë jashtë funksionit që nga viti 2024, por një njësi më e vogël që funksionon me biomasë është planifikuar si zëvendësim nga viti 2030 e tutje. Shih NOSBiH, [Indikativni plan razvoja proizvodnje 2025-2034, Nezavisni operator sistema u Bosni i Hercegovini, Qershor 2024](#).

⁵⁶ Klix.ba, ["Šta bi značilo prelazak Bloka 3 Termoelektrane Tuzla na biomasu i kada bi se to moglo desiti"](#), Klix, 21 janar 2024.

⁵⁷ Rjeti CEE Bankwatch, [Përditësimi i raportit "Përmbaju ose Mbyll" për vitin 2022, CEE Bankwatch Network, qershor 2022](#).

⁵⁸ Këshilli Ministror i Komunitetit Energjetik, [D/2015/07/MC-EnC: Për ndryshimin e Vendimit D/2013/05/MC-EnC të 24 tetorit 2013 për zbatimin e Direktivës 2001/80/KE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit për kufizimin e emetimeve të disa ndotësve në ajër nga termocentralet e mëdha me djegie dhe për ndryshimin e Shtojcës II të Traktatit të Komunitetit Energjetik, Komuniteti Energjetik, 16 tetor 2015](#).

⁵⁹ Sekretariati i Komunitetit Energjetik, [Sekretariati nis procedurën e kontesteve kundër Bosnjës dhe Hercegovinës për shkelje të Direktivës për Termocentralet e Mëdha me Djegie në rastin e Tuzla 4 dhe Kakanj 5](#).

⁶⁰ Elektroprivreda Bosne i Hercegovine, [Potpisan Ugovor za projektat odsumporavanja u TE „Kakanj“, Elektroprivreda Bosne i Hercegovine, Dhjetor 2024](#).

⁶¹ Elektroprivreda Bosne i Hercegovine, [Plan poslovanja za period 2025 - 2027. godina](#).

⁶² Po aty.

⁶³ Elektroprivreda Bosne i Hercegovine, ["Korigovan Finansijski izvještaj o poslovanju za 2023. godinu - gubitak 331 milion KM"](#), Elektroprivreda Bosne i Hercegovine, 5 korrik 2024. Raporti i saj financiar për vitin 2024 nuk duket të jetë i disponueshëm që nga fillimi i majit 2025.

⁶⁴ Psh. nga Ministria e Tregtisë së Jashtme dhe Marrëdhënieve Ekonomike të Bosnjës dhe Hercegovinës, [Strategjia Kornizë e Energjisë e Bosnjës dhe Hercegovinës deri në vitin 2035, Ministria e Tregtisë së Jashtme dhe Marrëdhënieve Ekonomike të Bosnjës dhe Hercegovinës](#), 69, qasur më 2 prill 2025.



Miniera e qymyrit në Banovici, Bosnja dhe Hercegovina

Foto: Matteo Trevisan, realizuar si pjesë e projektit fotografik me titull "Më i nevojshëm se dielli"

Lidhur me Ugljevikun, siç u përmend më sipër dhe u diskutua më hollësisht në botimet e mëparshme të Përmbaju ose Mbyll, termocentrali mori leje operimi për njësinë de-SO_x në nëntor 2021.⁶⁵ Por kjo nuk ka rezultuar në një ulje të emetimeve dhe nuk duket e mundshme që kjo të ndodhë së shpejti. Operatori i termocentralit RiTE Ugljevik deklaroi në një përgjigje të prillit 2023 drejtuar Qendrës për Mjedis se njësia e desulfurizimit nuk po funksionon vazhdimisht sepse është 'barrë ekonomike'.⁶⁶ Edhe pse qartazi nuk i përmbushi kërkesat, operatorit iu dha leje e re mjedisore deri në vitin 2029.⁶⁷

Ndotja është gjithashtu larg të qenit problemi i vetëm me të cilin përballen termocentralet Ugljevik dhe Gacko për momentin. Në dimrin e viteve 2024 dhe 2025, Ugljevik doli dy herë jashtë funksionit për shkak të mungesës së qymyrit, dhe në shkurt të vitit 2025, Ministri i Energjisë dhe Minierave i Republikës Srpska, Petar Đokić, u citua se kishte thënë se do të ishte më lirë të ndërtohej një termocentral i ri me qymyr sesa të mirëmbaheshin ato ekzistuese, pasi do të nevojiteshin rreth 357 milionë euro për modernizimin e tyre.⁶⁸

Por është e vështirë të kuptohet se nga do të vijnë fondet edhe për një termocentral të ri. Termocentrali Ugljevik III i Comsar Energy ka marrë vazhdimisht miratime për vlerësime të ndikimit në mjedis dhe leje mjedisore – të cilat janë kontestuar në gjykatë për vite me radhë – pavarësisht shkeljeve të dukshme ligjore në proces dhe boshllëqeve në studime, por nuk ka arritur të sigurojë fonde.⁶⁹ E njëjta gjë vlen edhe për termocentralin Gacko II, të promovuar nga Elektroprivreda Republike Srpske prej të paktën dhjetë vjetësh, i cili po i nënshtrohet një procesi vlerësimi të ndikimit në mjedis, por nuk ka burime të konfirmuara financimi.⁷⁰

⁶⁵ Ministria e Planifikimit Hapësinor, Ndërtimeve dhe Ekologjisë e Republikës Srpska, [Vendimi nr. 15.03-360-164/21](#).

⁶⁶ RiTE Ugljevik, Shkresa nr: 14047/23, 18 prill 2023.

⁶⁷ Ministria e Planifikimit Hapësinor, Ndërtimeve dhe Ekologjisë e Republikës Srpska, [Rinovimi i Lejes Mjedisore Nr. 15.4.1-96-73/24](#), 12 gusht 2024.

⁶⁸ Vladimir Spasić, 'leftinije izgraditi novu termoelektranu, nego održavati Gacko i Ugljevik', [Lajme për Energjinë e Gjelbër në Ballkan](#), 5 shkurt 2025.

⁶⁹ Rrjeti CEE Bankwatch, [Termocentrali i linjitet Ugljevik III, Bosnjë dhe Hercegovinë, CEE Bankwatch Network](#), përditësuar për herë të fundit në janar 2024.

⁷⁰ Ministria e Planifikimit Hapësinor, Ndërtimeve dhe Ekologjisë e Republikës Srpska, [Vendimi nr. 15.4.1-96-150/23](#), 22 janar 2024.

Harmonizimi me vlerat kufitare të NERP në vitin 2024

Të pesë njësitë me qymyr të Kosovës (Kosova A3, A4 dhe A5 dhe Kosova B1 dhe B2) janë përfshira në NERP.


Në vitin 2024, flota e qymyrit e Kosovës shkeli përsëri të tri kufiret kombëtare të ndotësve, pavarësisht një uljeje të lehtë të emetimeve të SO₂ në vitin e kaluar. Vetëm Kosova A3 arriti të përmbushte kufirin e vet të SO₂, por kjo nuk kishte të bënte fare me kontrollin e ndotjes – përkundrazi, mund t'i atribuohet orëve më të ulëta të funksionimit.

Emetimet e pluhurit kanë qenë gjithmonë problemi më i madh i ndotjes në vend. Në vitin 2024 ato vazhduan të ishin tepër të larta, por çuditërisht, ishin gjithashtu të vetmet emetime të vendit që janë pak më të ulëta se ato të vitit 2023. Emetimet e dioksidit sulfurik dhe të oksideve të azotit janë rritur krahasuar me vitin e kaluar.

Ndotja nga pluhuri ishte 4.1 herë mbi kufirin kombëtar të përcaktuar në Shtojcën ⁷¹ të NERP-së dhe arriti në total 5 606 tonë. Vetëm Kosova B1 emetoi pothuajse dyfishin e vlerës kufitare të pluhurit në vitin 2024, duke lëshuar gjithsej 2 635 tonë në atmosferë. Kosova B2, e cila emetoi 2 304 tonë pluhur, e uli ndotjen në vitin 2024 krahasuar me vitin e kaluar; kjo prapëseprapë arriti në 5,55 herë më shumë se niveli i lejuar, krahasuar me shkeljen e vitit 2023 prej 9,2 herësh.

⁷¹ Kjo shtojcë nuk është pjesë e NERP-it në dispozicion për publikun dhe i është zbuluar autorëve të këtij raporti.


Figura 9: Emetimet e pluhurit nga termocentralet me qymyr të Kosovës, të përfshira në NERP, krahasuar me kufijtë kombëtarë të emetimeve, 2018–2024 (Të dhënat e vitit 2019 nuk janë në dispozicion)



Emetimet e SO₂ ishin 1,1 herë më të larta se kufiri kombëtar në vitin 2024, ose 11 713 tonë. Kjo vjen pas një pajtueshmërie afatshkurtër në vitin 2023, e cila ishte e vështirë të shpjegohej, pasi nuk ishin instaluar pajisje për de-SO_x.

Megjithatë, emetimet e raportuara të vendit janë në fakt vlerësime: Kosova A nuk ka pajisje për monitorim të vazhdueshëm dhe pajisjet e monitorimit të Kosova B janë funksionale vetëm në intervale të rregullta testimi, midis të cilave emetimet llogariten matematikisht.

Figura 10: Emetimet e dioksidit sulfurik nga termocentralet me qymyr të Kosovës, të përfshira në NERP, krahasuar me kufijtë kombëtarë të emetimeve, 2018–2024 (Të dhënat e vitit 2019 nuk janë në dispozicion)




Pasi arritën një minimum historik në vitin 2023, emetimet e NO_x në Kosovë u rritën ndjeshëm në vitin 2024 – në 16 851 tonë. Vendi dallohet në nivel rajonal për shkeljen më të lartë të kufirit të NO_x – 3,1 herë më shumë se sa lejohet. Në nivelin e njësive individuale, Kosova A5 pati shkeljen më të lartë të kufirit të saj individual, duke emetuar 3,91 herë më shumë se sa lejohet, por të gjitha njësitë në Kosovë i shkelën kufijtë e tyre individualë me të paktën 2,5 herë.

Termocentrali i Kosova B, Kosovë

Foto: Matteo Trevisan, realizuar si pjesë e projektit fotografik me titull "Më i nevojshëm se dielli"

Figura 11: Emetimet e oksideve të azotit nga termocentralet me qymyr të Kosovës, të përfshira në NERP, krahasuar me kufijtë kombëtarë të emetimeve, 2018–2024 (Të dhënat e vitit 2019 nuk janë në dispozicion)



Karakteristika kryesore e NERP-së së Kosovës është mospërputhja midis kufijve maksimalë për tre ndotësit që shfaqen në pjesën kryesore të dokumentit⁷² dhe ato të llogaritura në Shtojcën 2 të NERP-së. Kjo shtojcë nuk është pjesë e NERP-së që është në dispozicion të publikut dhe i është zbuluar autorëve të këtij raporti.

Kufiri i SO₂ i listuar në pjesën kryesore të NERP-së ndjek vetëm një rënie lineare deri në vitin 2021, dhe më pas ato rriten pak në vitet 2022 dhe 2023. Kufiri i NO_x gjithashtu rritet pak në vitin 2024 krahasuar me vitin 2023 – e kundërta e asaj që duhet të ndodhë. Prandaj, në këtë raport autorët kanë marrë vlerat e kufirit nga shtojca, sepse ato duket të jenë më në përputhje me udhëzimet e politikave të Komunitetit Energjetik për përgatitjen e NERP-ve,⁷³ edhe pse kufijtë për pluhurin dhe NO_x janë më të lartë se ato në pjesën kryesore të dokumentit.

⁷² Qeveria e Kosovës, Plani Kombëtar i Zvogëlimit të Emetimeve: Kosova, Komuniteti Energjetik, 2018.

⁷³ 'Vlerat kufitare për vitet 2019 deri në 2022 do të përcaktohen duke siguruar një trend linear midis vlerave të viteve 2018 dhe 2023. Në praktikë, kjo do të thotë që vlerat kufitare nuk do të ndryshojnë midis viteve 2018 dhe 2023, përveç NO_x.' Komuniteti Energjetik, Udhëzimet e Politikave 03/2014, Komuniteti Energjetik, dhjetor 2014.

Kosova (2024)

	Vlera kufitare SO ₂	Emetimet e SO ₂	Vlera kufitare e pluhurit	Emetimet e pluhurit	Vlera kufitare e NO _x	Emetimet e NO _x
Vlera kufitare kryesore sipas NERP	9 497	11 713	475	5 606	6 129	16 851
Vlera kufitare e Shtojcës 2	10 894		1 362		5 446	

Në dhjetor 2023, në një vendim të Këshillit Ministror⁷⁴ u deklarua se Kosova është në shkelje të Traktatit të Komunitetit Energjetik, së bashku me Bosnjën dhe Hercegovinën dhe Maqedoninë e Veriut. Raporti i Zbatimit të Komunitetit Energjetik 2024⁷⁵ thekson se 'shkeljet e konsiderueshme të kufijve për oksidet e azotit dhe pluhurin mbeten të patrajtuara dhe vendimi përkatës i Këshillit Ministror nuk është zbatuar për këtë arsye'.

Investimet aktuale për kontrollin e ndotjes

Drafti i Planit Kombëtar të Energjisë dhe Klimës (NECP) të Kosovës, që i është dorëzuar Sekretariatit të Komunitetit Energjetik në korrik 2023, përforcon Strategjinë e Energjisë të vendit të publikuar një vit më herët⁷⁶ dhe pretendon se:

Njësitë e termocentralit 'Kosova B1 dhe B2' do të rinovohen për të ruajtur sigurinë e furnizimit dhe për t'i ulur emetimet. Rinovimi i njësive të Kosova B1 dhe B2 do të kryhet në dy faza, dhe deri në fund të vitit 2025 dhe përkatësisht në vitin 2026, të dy njësitë do të operojnë në një mënyrë më efikase dhe të besueshme, duke përmbushur standardet e detyrueshme të emetimeve të Direktivës për Emetimet Industriale.⁷⁷

Planifikimi buxhetor i Strategjisë Kombëtare të Energjisë parashikon një total prej 178 milionë eurosh që do të shpenzohen për rinovimin e secilës prej dy njësive të TC Kosova B (Kosova B1 dhe Kosova B2) ndërmjet viteve 2023 dhe 2025.

Në prill të vitit 2025, faqja e internetit e zyrës së Kryeministrit njoftoi⁷⁸ për fillimin e punimeve të modernizimit në termocentralin Kosova B, me një kosto në vlerë prej 56,5 milionë eurosh, që do të mbulohet plotësisht nga buxheti i kompanisë shtetërore të energjisë.

Sipas NECP-së, një pjesë e buxhetit prej 178 milionë eurosh do të sigurohet nga Korporata Energjetike e Kosovës (KEK) ndërsa një pjesë tjetër do të mbulohet nga një grant i BE-së. Paratë e grantit do të përdoren për t'i mbuluar shpenzimet për filtrat elektrostatikë dhe një instalim për de-NO_x.⁷⁹

Megjithatë, më shumë se gjashtë vjet më parë, NERP i Kosovës parashikoi që Kosova B1 do t'i nënshtrohej rikonstruksionit deri në vitin 2021⁸⁰ në mënyrë që emetimet e pluhurit dhe NO_x të jenë në përputhje me vlerat kufitare të emetimeve të Direktivës për Emetimet Industriale. Parashikohej që njësia B2 të ndiqte këtë shembull dhe të përmbushte kërkesat deri në vitin 2022, me përdorimin e një granti prej 76,4 milionë eurosh në kuadër të Instrumentit të Parë Anëtarësimit II (IPA II) të Komisionit Evropian, të nënshkruar në nëntor 2019.

Këto punime janë shtyrë vazhdimisht. Raporti i fundit i prillit 2025 thotë se projekti i de-NO_x dhe filterave elektrostatikë është shtyrë për në vitin 2026 për njësinë B1 dhe në vitin 2027 për njësinë B2, dhe se në vitin 2025, turbina e njësies B2 do të modernizohet dhe shufrat e gjeneratorit të saj do të zëvendësohen.⁸¹

Një tjetër propozim – për instalimin e de-SO_x – u përfshi në listën indikative të projekteve sipas Kornizës së Investimeve në Ballkanin Perëndimor (WBIF) që vendi ia dorëzoi Komisionit Evropian si pjesë e Agjendës së Reformës në vitin 2024.⁸² Përshkrimi i projektit parashikon një investim prej 105 milionë eurosh për dy njësitë pa cekur një afat kohor konkret, por duke vënë në dukje se "Dizajni paraprak, dizajni i detajuar, dokumentacioni i tenderit dhe nënshkrimi i kontratës së ndërtimit nuk kanë filluar". Kjo është edhe më shqetësuese, pasi ky veprim u bë pas shtatë vitesh mosrespektimi. Projekti nuk ka gjasa të marrë fonde nga WBIF në kuadër të Programit të Reformës dhe Zhvillimit, pasi nuk lejohet mbështetje për lëndët djegëse fosile dhe nuk do të përputhej me afatin kohor të shpenzimeve. Megjithatë, përfshirja e këtij projekti në listën për financim tregon se planet e desulfurizimit janë në hapat e tyre fillestarë.

Strategjia e Energjisë e vendit, në mënyrë shqetësuese, përmendi gjithashtu se një nga njësitë e Kosova A "do të rinovohet deri në fund të vitit 2024, ndërsa vendimi për rinovimin ose çmontimin gradual të njësies së dytë do të merret më së voni në vitin 2024".⁸³ Ka disa probleme me këtë, por shqetësimi më i madh është vjetërsia e këtyre njësive – mbi 50 vjet.

⁷⁴ Këshilli Ministror i Komunitetit Energjetik, [Vendimi 2023/05/MC-EnC mbi dëshkrimin e Kosovës* për të përmbushur Traktatin e Komunitetit Energjetik në Rastin ECS-8/21](#).

⁷⁵ Komuniteti Energjetik, [Raporti Vjetor i Zbatimit 2024, Komuniteti Energjetik](#), 65, 1 nëntor 2024.

⁷⁶ Qeveria e Kosovës, [Strategjia e Energjisë e Republikës së Kosovës 2022-2031](#), Qeveria e Kosovës, prill 2022.

⁷⁷ Qeveria e Kosovës, [Plani Kombëtar i Energjisë dhe Klimës i Republikës së Kosovës 2025-2030 \(versioni i parë draft\)](#), Komuniteti Energjetik, 82, 2023.

⁷⁸ Zyra e Kryeministrit të Kosovës, [Fillojnë punimet për modernizimin e termocentralit Kosova B – investim me vlerë 56,5 milionë euro nga Korporata Energjetike e Kosovës](#), Zyra e Kryeministrit të Kosovës, 28 prill 2025.

⁷⁹ Po aty.

⁸⁰ Qeveria e Kosovës, [Plani Kombëtar i Zvogelimit të Emetimeve: Kosova](#), 11.

⁸¹ Qeveria e Kosovës, [Raporti i progresit për vitin 2024 i programit të zbatimit të strategjisë së energjisë në Kosovë \(KESIP\) për periudhën 2022 – 2025](#), Qeveria e Kosovës, Prill 2025.

⁸² Komisioni Evropian, DG ENEST, Programi i Reformës dhe Zhvillimit për Ballkanin Perëndimor, [Agjenda e Reformës së Kosovës](#), versioni i 6 shtatorit 2024.

⁸³ Qeveria e Kosovës, [Strategjia e Energjisë e Republikës së Kosovës 2022-2031](#).

Afati i vitit 2024 doli të ishte i pamundur për t'u përmbushur, por në fillim të janarit 2025, zyra e Kryeministrit bëri një njoftim të papritur⁸⁴ se po fillonin 'aktivitetin e prokurimit (faza I Parakualifikimi) të projektit kapital Rehabilitimi dhe Modernizimi i Njësive A3 të Termocentralit Kosova A'. Kostoja e shpallur është 137 milionë euro, tashmë 17 milionë euro më e madhe se sa ishte vlerësuar tre vjet më parë në Strategjinë e Energjisë, duke ngritur shqetësime shtesë në lidhje me barrën në rritje mbi buxhetin publik. Njoftimi përmendi gjithashtu një zgjatje të pritur të kohës së funksionimit të termocentralit prej 20 vitesh, e cila është e vështirë të imagjinohet nga pikëpamja e sigurisë, e lëre më nga aspektet mjedisore dhe ekonomike.

Strategjia e Energjisë vlerëson se do të nevojiten 120 milionë euro të tjera për ta rehabilituar një njësi të dytë në Kosova A, përveç 137 milionë eurove në Kosova A3. Prapë, nuk është e qartë nëse Kosova mund ta sigurojë këtë financim.

Mali i Zi

Termocentralit me qymyr Pljevlja shkel ligjin për të pestin vit me radhë

Mali i Zi ka vetëm një termocentral të madh me djegie të brendshme, termocentralin e linjtit Pljevlja me 225 MWe, i cili ka vetëm një njësi. Prandaj, ai nuk mund t'i nënshtrohet një Plani Kombëtar të Zvogëlimit të Emetimeve. Në vend që të sigurohej se ishte në përputhshmëri me LCPD deri në vitin 2018, u zgjodh opsioni 'opt-out' për funksionim të afatizuar, në të cilin Pljevlja mund të operonte për një total prej 20 000 orësh ndërmjet 1 janarit 2018 dhe 31 dhjetorit 2023. Pas kësaj, siç shpjegohet më sipër, ose duhej të mbyllej ose t'i nënshtrohej një rinovimi, që së paku do ta sillte atë në vijë me vlerat kufitare të emetimeve për termocentralet e reja nga Shtojca V, Pjesa 2 e Direktivës së Emetimeve Industriale.

Sipas lejes së saj të integruar mjedisore,⁸⁵ të lëshuar në mars të vitit 2018, Pljevlja duhej të harmonizohet me LCP BREF standardet më të fundit të BE deri në vitin 2023 dhe ishte termocentrali i parë ekzistues në rajon nga i cili kërkohej që ta bënte këtë.

Megjithatë, menaxhmenti i kompanisë shtetërore të energjisë Elektroprivreda Crne Gore (EPCG) i përdori 20 000 orët që kishte në dispozicion dhe termocentrali deri në fund të vitit 2020 tashmë kishte tejkaluar këtë kufi.⁸⁶ Por nuk u ndal me kaq, duke funksionuar plus 6 450 orë në vitin 2021⁸⁷ dhe 6 949 të tjera në vitin 2022.⁸⁸ Raporti i saj për vitin 2023 rendit 6 949 orë më shumë,⁸⁹ dhe në vitin 2024 funksionoi për 6 813 orë më shumë.⁹⁰

Në prill të vitit 2021, Sekretariati i Komunitetit Energjetik hapi një rast shkeljeje kundër Malit të Zi,⁹¹ dhe në shkurt 2023 lëshoi një opinion të argumentuar,⁹² ndjekur nga një kërkesë e argumentuar drejtuar Këshillit Ministror në korrik 2023.⁹³ Këshilli Ministror ende nuk ka marrë vendim që konfirmon shkeljen, pavarësisht se është një rast i qartë i shkeljes.

Siç është përshkruar në botimet e mëparshme të revistës 'Përmbaju ose Mbyll', qeveritë e njëpasnjëshme në Mal të Zi nuk kanë ndërmarrë asnjë veprim kundër operatorit të termocentralit EPCG.

Emetimet në vitin 2024

Në vitin 2024, emetimet e dioksidit të sulfurit në Pljevlja arritën në 39 140 tonë, pak më pak se në vitin 2023 (44 017 tonë) dhe 2022 (46 504 tonë). Emetimet e pluhurit në vitin 2024 ranë në 793 tonë nga një rekord prej 1 130 tonë në vitin 2023, por kjo mbetej shifër më e lartë se çdo vit tjetër që nga viti 2018. Emetimet e NO_x – 3 682 tonë – mbetën pothuajse të njëjta si në vitin 2023 (3 982 tonë) dhe 2022 (3 954 tonë).^{94,95}

Që nga viti 2018, secili prej tre ndotësve ka kaluar një trend të ndryshëm. Emetimet e SO₂ janë rritur dhe ulur, dhe arsyet nuk janë plotësisht të qarta. Ato nuk shpjegohen plotësisht nga ndryshimet vjetore në orët e operimit.

⁸⁴ Zyra e Kryeministrit të Kosovës, [Korporata Energjetike e Kosovës investon 137 milionë euro për rehabilitimin dhe modernizimin e Njësive A3 të Termocentralit Kosova A](#), Zyra e Kryeministrit të Kosovës, 24 janar 2025.

⁸⁵ Agjencia e Mbrojtjes së Mjedisit të Malit të Zi [faqja e internetit](#), qasja e fundit më 24 maj 2021. Leja nuk është më në internet; vetëm lista e masave që duhen ndërmarrë është ende e disponueshme në internet, por njoftimi në lidhje me lejen nuk është ende i publikuar.

⁸⁶ Orët e operimit nga raportet e Malit të Zi për Agjencinë Evropiane të Mjedisit, [EIONET, Baza Qendrore e të Dhënave](#), për vitet 2018, 2019 dhe 2020.

⁸⁷ Agjencia Evropiane e Mjedisit, [EIONET, Baza Qendrore e të Dhënave, EIONET](#), raportuar më 15 prill 2022.

⁸⁸ Agjencia Evropiane e Mjedisit, [EIONET, Baza Qendrore e të Dhënave, EIONET](#), raportuar më 13 prill 2023.

⁸⁹ Agjencia Evropiane e Mjedisit, [EIONET, Baza Qendrore e të Dhënave, EIONET](#), raportoi më 8 korrik 2024. Është e mundur që kjo shifër të mos jetë përditësuar nga viti 2022, pasi edhe atëherë ishte e njëjta shifër.

⁹⁰ Agjencia Evropiane e Mjedisit, [EIONET, Baza Qendrore e të Dhënave, EIONET](#), raportuar më 13 Mars 2025.

⁹¹ Sekretariati i Komunitetit Energjetik, [Rasti ECS-15/21: Mali i Zi / Mjedisit](#).


⁹² Sekretariati i Komunitetit Energjetik, ["Sekretariati dërgon Opinion të Argumentuar për të adresuar mospërputhjen e TC Pljevlja me Direktivën për Termocentralet të Mëdha me Djegie të Brendshme", Komuniteti Energjetik](#), 15 shkurt 2023.

⁹³ Sekretariati i Komunitetit Energjetik, [Rasti ECS 15/21: Mali i Zi/ Mjedisit, Komuniteti Energjetik](#), qasur më 11 korrik 2024.

⁹⁴ Agjencia Evropiane e Mjedisit, [EIONET, Baza Qendrore e të Dhënave, EIONET](#), raportuar më 8 korrik 2024.


⁹⁵ Agjencia Evropiane e Mjedisit, [EIONET, Baza Qendrore e të Dhënave, EIONET](#), të dhëna për vitet 2018, 2019, 2020 dhe 2021.

Figura 12: Emetimet e dioksidit sulfurik nga termocentrali me qymyr Pljevlja në Malin e Zi, 2018–2024




Emetimet e NO_x ranë ndjeshëm në vitin 2019, por që atëherë kanë lëvizur rreth niveleve të ngjashme. Sërish, arsyet janë të panjohura dhe nuk shpjegohen nga orët e punës apo investimet e bëra.

Figura 13: Emetimet e oksideve të azotit nga termocentrali me qymyr Pljevlja në Malin e Zi, 2018–2024



Megjithatë, emetimet e pluhurit kanë pasur një trend rritës – në vend të rënies – që nga viti 2018, dhe pësuan një rritje masive në vitin 2023, duke rënë përsëri pak në vitin 2024.

Figura 14: Emetimet e pluhurit nga termocentrali me qymyr Pljevlja në Malin e Zi, 2018–2023



Investimet aktuale për kontrollin e ndotjes

Që nga fillimi i majit 2025, është duke u zhvilluar një projekt modernizimi në termocentralin e Pljevljes, në mënyrë që të përmbushë standardet LCP BREF të BE-së.

Në qershor të vitit 2020, qeveria e atëhershme e Malit të Zi nënshkroi një kontratë për rinovim të termocentralit me një konsorcium të udhëhequr nga kompania kineze Dongfang (DEC International), e cila përfshinte gjithashtu kompanitë lokale të lidhura mirë njëra me tjetrën si Bemaks, BB Solar dhe Permonte.⁹⁶

Procesi është komprometuar nga parregullsia të shumta, siç edhe është paraqitur në botimet e mëparshme të Përmbaju ose Mbyll,⁹⁷ dhe nuk është aspak e qartë nëse projekti do të sjellë përmirësimet e pritura. Punimet kanë nisur në prill të vitit 2022, gati dy vjet pas nënshkrimit të kontratës.⁹⁸ Atëherë përfundimi i punimeve pritej në tetor 2024. Në mars të vitit 2023 u raportua se nga Kina do të vinin paisjet që duhej instaluar, pasi që të kishin përfunduar punimet përgatitore.⁹⁹ Pas vonesave të mëtejshme, në fund të marsit 2025, u njoftua më në fund se termocentrali do të dilte jashtë funksionit dhe do të mbetej ashtu për shtatë muaj e gjysmë.¹⁰⁰

Që nga momenti kur u nënshkrua kontrata me Dongfang në vitin 2020, organizatat e shoqërisë civile vunë në dyshim mungesën e një studimi fizibiliteti për projektin e modernizimit.¹⁰¹ Termocentrali është ndërtuar në vitin 1982, kështu që funksionimi i tij i mëtejshëm do të jetë i kufizuar dhe nuk është e qartë nëse instalimi i pajisjeve të shtrenjta të desulfurizimit do të shpagohet. Procedura e tenderimit gjithashtu ngjalli dilema pasi ofertuesve nuk u kërkonte të shpjegonin se cilën zgjidhje teknike do të përdornin, por vetëm të respektonin vlerat kufitare të emetimeve. Oferta e Dongfang ishte dukshëm më e ulët se ajo e konsorciumeve konkurruese dhe një prej tyre, Hamon-Rudis, vuri në dyshim nëse ishte e mundur të arrihej ky qëllim me një ofertë kaq të ulët.¹⁰²

⁹⁶ Lajme për Energjinë e Gjelbër në Ballkan, 'EPCG nënshkruan marrëveshjen për kontroll mjedisor të termocentralit Pljevlja', Lajme për Energjinë e Gjelbër në Ballkan, 10 qershor 2020.

⁹⁷ Rrjeti CEE Bankwatch, Përditësimi i raportit "Përmbaju ose Mbyll" për vitin 2022.

⁹⁸ Vladimir Spasić, 'EPCG započela ekološku rekonstrukciju TE Pljevlja', Lajme për Energjinë e Gjelbër në Ballkan, 24 prill 2022.

⁹⁹ Sasha Bezarević, 'Stiže oprema iz Kine, rekonstrukcije Termoelektrane Pljevlja pri kraju', RTCG, 4 mars 2023.

¹⁰⁰ Elektroprivreda Crne Gore, 'TE Pljevlja ulazi u završnu fazu ekološke rekonstrukcije, EPCG, 31 mars 2025.

¹⁰¹ Radio Televizija Crne Gore, 'Objaviti studiju ekonomske opravdanosti rekonstrukcije TE Pljevlja', Radio Televizija Crne Gore, 24 korrik 2020.

¹⁰² Pippa Gallop, 'OIQ-të presin procedurë shkeljeje të Komunitetit Energjetik për termocentralin malazez të qymyrit', CEE Bankwatch Network, 19 prill 2021.

Doli që Hamon-Rudis kishte të drejtë, pasi çmimi i projektit u rrit më vonë në 70 milionë euro për shkak të punimeve rreth përshtatjes së bojlerit.¹⁰³ Kohët e fundit, 80 milionë euro janë përmendur në media.¹⁰⁴ Mbetet të shihet se cili do të jetë çmimi përfundimtar dhe nëse termocentrali 42-vjeçar më tutje do të jetë në gjendje t'i përbushë LCP BREF standardet e BE.

Pavarësisht afatit të qershorit 2024 për dorëzimin e NECP-ve përfundimtare, drafti i Malit të Zi u dorëzua Sekretariatit të Komunitetit Energjetik tek në dhjetor 2024.¹⁰⁵ Edhe tani, data e heqjes graduale të qymyrit nga përdorimi mbetet e paqartë. Në qershor 2021, Mali i Zi njoftoi se do të heqë dorë nga qymyri deri në vitin 2035, më së voni¹⁰⁶ dhe NECP e përmend këtë datë një herë, por edhe data të tjera, më vonë, si p.sh. vitin 2040.

Edhe viti 2035 duket tepër vonë për mbylljen e termocentralit në realitet. Eksportet e energjisë elektrike në Itali, të mundësuar nga hapja e një kabloje nënujore në fund të vitit 2019, mund të ulen duke filluar nga 1 janari 2026 për shkak të tarifave CBAM, duke e privuar termocentralin e Pljevljes nga një burim fitimprurës të ardhurash dhe duke mbyllur një boshllëk ligjor që po nxit funksionimin e tij të paligjshëm. Mali i Zi mund të shmangë që energjia elektrike t'i nënshtrohet tarifave CBAM, ndër të tjera, duke rritur çmimin e karbonit në nivelin e Sistemit të Tregtimit të Emetimeve të BE-së deri në vitin 2030. Kjo do të thotë se do të duhet të rrisë gradualisht çmimin nga minimumi aktual prej 24 eurosh për ton, por deri më tani nuk ka ndërmarrë asnjë veprim për ta bërë këtë.

Duke pasur parasysh se bëhet fjalë për një vend të vogël, do të duheshin vetëm edhe disa ferma diellore dhe me erë që do të bëjnë ndryshim të madh për të mbuluar kërkesën për energji elektrike të Malit të Zi, por viteve të fundit progresi ka qenë i ngadalshëm.

Pika pozitive është energjia diellore në kulme, e cila ka marrë hov falë skemave Solari të EPCG-së. Këto kishin rezultuar në instalimin e 70 MW të paneleve fotovoltaike diellore në më shumë se 7,000 ndërtesa deri në prill 2025.¹⁰⁷ Por energjia diellore në shkallë të gjerë po mbetet prapa, me termocentralin e parë prej 4,42 MW që kishte filluar funksionimin tek në dhjetor 2023.¹⁰⁸ Janë planifikuar shumë termocentrale të tjera në shkallë të gjerë,¹⁰⁹ por mbetet për t'u parë se sa do të ndërtohen. Që nga viti 2019, asnjë fermë e re energjisë së erës nuk ka filluar të funksionojë, megjithëse parku i energjisë së erës në Gvozd është aktualisht në ndërtim e sipër dhe, sipas EPCG, testimi mund të fillojë qysh në fund të vitit 2025.¹¹⁰

¹⁰³ Elektroprivreda Crne Gore deklaroi se 15 milionë euro shtesë ishin për një projekt të veçantë për adaptimin e bojlerit, por pranoi se ishte i lidhur me projektin e modernizimit. Draško Milačić, 'Rekonstrukcija Termoelektrana će koštati oko 70 miliona', *Dan*, 18 dhjetor 2021.

¹⁰⁴ Radio Televizija Crne Gore, 'Građane Pljevalja čeka bolja i zdravija budućnost', *Radio Televizija Crne Gore*, 6 Mars 2024.

¹⁰⁵ Sekretariati i Komunitetit Energjetik, *Qeverisja dhe Planeti Kombëtare të Energjisë dhe Klimës – Mali i Zi harton Planin Kombëtar të Energjisë Kombëtare (NECP)*.

¹⁰⁶ Lajme për Energjinë e Gjelbër në Ballkan, 'Mali i Zi njofton heqjen graduale të qymyrit deri në vitin 2035', *Lajme për Energjinë e Gjelbër në Ballkan*, 1 korrik 2021.

¹⁰⁷ Elektroprivreda Crne Gore, 'Vendosja e parë pozitive', *EPCG Solar Gradnja*, 15 Prill 2025.

¹⁰⁸ Ekovjesnik, 'S radom počela prva solarna elektrana u kopnenom dijelu Crne Gore', *Ekovjesnik*, 27 dhjetor 2023.

¹⁰⁹ Shih për shembull Vladimir Spasić, 'Vlada Crne Gore dala zeleno svetlo za četiri solarne elektrane snage 127 MW', *Lajme për Energjinë e Gjelbër në Ballkan*, 17 Mars 2025.

¹¹⁰ Marija Mirjačić, 'Gvozd testira turbine do decembra: EPCG gradi pristupne puteve za transport opreme za vjetroelektranu na Krnovu', *Gazeta Vijesti*, 29 mars 2025.

Termocentrali i Pljevljes, Mali i Zi

Foto: CEE Bankwatch Network

Maqedonia e Veriut

Harmonizimi me vlerat kufitare të NERP në vitin 2024

NERP i Maqedonisë së Veriut u miratua në vitin 2017, pa asnjë konsultim publik ose një vlerësim strategjik mjedisor. Ai përfshin të tetë termocentralet e mëdha ekzistuese me djegie të brendshme nga sektori energjetik, nga të cilat tre janë me qymyr, një përdor naftë industriale dhe dy janë termocentralet ngrohjeje me gaz fosil që kanë qenë të paktën pjesërisht funksionale gjatë periudhës së zbatimit të planit. Dy impiantet tjera janë ngrohore në rafinerinë e vjetër të naftës, e cila edhe pse nuk është mbyllur zyrtarisht, ka më shumë se dhjetë vjet që nuk funksionon.

Gjatë shtatë viteve që nga kalimi i afatit të harmonizimit me LCPD, suksesi i vetëm i vendit është se u largua edhe më shumë nga harmonizimi, si në reduktimin e emetimeve, ashtu edhe në pjesën e monitorimit. Asnjë nga termocentralet me qymyr ende nuk ka monitorim të vazhdueshëm dhe deri më tani ata kanë raportuar vetëm në bazë të përllogaritjeve nga matjet e bëra një herë në muaj. Në vitin 2023, situata u përkeqësua më shumë. Për shkak se monitorimi mujor ishte jo i besueshëm dhe tregoi variacione të mëdha në matje, autoritetet përdorën faktorët e emetimeve nga vitet e mëparshme në kombinim me inputin e energjisë termike në teraxhul, për të gjeneruar një vlerësim të emetimeve nga djegia e qymyrit. Megjithatë, gjasat janë të vogla që këto vlerësime t'i paraqesin emetimet reale me saktësi.¹¹¹ I njëjti shpjegim mbetet në tabelën e raportimit të emetimeve për vitin 2024, por teksti dhe vitet nuk janë përditësuar, kështu që është e paqartë nëse kjo situatë është zgjidhur.

Përveç kësaj, kompania publike e energjisë elektrike Elektrani na Severna Makedonija (SH.A. ESM) nuk ka bërë investime në kontrollin e ndotjes për termocentralet me qymyr që nga viti 2013, kur njësitë 2 dhe 3 të Bitolës u ripajisën për të ulur emetimet e NO_x. Me uljen e kufijve për të gjithë ndotësit duke filluar nga viti 2024, mosrespektimi i rregullave nga ana e vendit është përkeqësuar edhe më shumë.


¹¹¹ Ioana Ciuta, Pippa Gallop dhe Davor Pehchevski, [Përditësimi i vitit 2024 "Përmbajë ose Mbyll", CEE Bankwatch Network](#), 32, shtator 2024.

Maqedonia e Veriut (2024)

Vlera kufitare e SO ₂	Emetimet e SO ₂	Vlera kufitare e pluhurit	Emetimet e pluhurit	Vlera kufitare e NO _x	Emetimet e NO _x
12 634	87 770	1 361	3 393	7 674	4 024

Emetimet e SO₂ nga djegia e qymyrit në vitin 2024 ishin më të ulëta se ato të vitit 2023, por mbetën shumë të larta me rreth 87 770 tonë. Megjithatë, ato janë goxha më lartë se kufiri kombëtar në krahasim me emetimet e SO₂ në vitin 2023, pothuajse shtatë herë më të larta se 15 855 tonët e lejuara.

Figura 15: Emetimet e dioksidit sulfurik nga termocentralet me qymyr të Maqedonisë së Veriut, të përfshira në NERP, krahasuar me kufijtë kombëtarë të emetimeve, 2018–2024




Siç edhe kishte ndodhur në vitet e mëparshme, oxhaqet e Bitola B 1 & 2 dhe Bitola B3 ishin ende kontribuesit më të lartë në vitin 2024. Ato emetuan 62 625 dhe 22 314 tonë respektivisht. **Emetimet nga Bitola B 1 & 2 ishin 11,4 herë më të larta se kufiri individual i termocentralit, dhe nga Bitola B3 ishin 9,4 herë më të larta se kufiri individual.**¹¹²

Kontributi i Oslomej ishte pak më i lartë se sa në vitin 2023, me 2 831 tonë – ende brenda kufirit të tij individual për shkak të orarit të kufizuar të funksionimit, por shumë larg kufirit prej 940 tonësh që duhet të arrijë deri në fund të periudhës së zbatimit të NERP në vitin 2027.

Emetimet e pluhurit nga prodhimi i energjisë me qymyr ranë pak në vitin 2024 krahasuar me vitin 2023, por, me 3 393 tonë, ato janë 2,5 herë më të larta se kufiri kombëtar prej 1 361 tonësh.

¹¹² Vlerat kufitare individuale për vitet 2024 dhe 2025 për termocentralet e mëdha me djegie të brendshme nuk janë dhënë në NERP. Ne i paraqitëm një kërkesë për qasje në informata Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Fizik për vlerat kufitare individuale, dhe përgjigja që morëm është se ato ishin llogaritur vetëm për vitet 2018, 2023, 2026 dhe 2027. Për shkak të kësaj, për krahasim përdorëm vlerat kufitare individuale të llogaritura bazuar në udhëzimet e Komunitetit Energetik për përgatitjen e NERP-ve: "Vlerat kufitare për vitet 2024 dhe 2025 do të përcaktohen duke siguruar një ulje lineare të vlerave kufitare të periudhës së viteve ndërmjet 2023 dhe 2026".

Figura 16: Emetimet e pluhurit nga termocentralet me qymyr të Maqedonisë së Veriut, të përfshira në NERP, krahasuar me kufijtë kombëtarë të emetimeve, 2018–2024




Njësitë Bitola B 1 & 2 dhe Bitola B3 kontribuan me respektivisht 2 278 tonë dhe 750 tonë emetime pluhuri. Në përgjithësi, termocentrali i Bitola-s po emeton më shumë se tre herë më shumë se kufijtë individualë të kombinuar të njësive. Oslomej shkeli kufirin e tij individual të pluhurit për herë të parë që nga viti 2018, pavarësisht orëve të pakta të funksionimit. Termocentrali emetoi 365 tonë, pak mbi kufirin e tij individual prej 345 tonësh.

Emetimet e raportuara të NO_x në Maqedoninë e Veriut vazhduan të bien krahasuar me vitet 2022 dhe 2023. 4 024 ton të emetuar në vitin 2024 janë brenda kufijve të vitit 2024 dhe madje edhe të vitit 2027 për NO_x .

Termocentrali i Bitolës, Maqedoni e Veriut
Foto: CEE Bankwatch Network

Figura 17: Emetimet e NO_x nga termocentralet me qymyr të Maqedonisë së Veriut, të përfshira në NERP, krahasuar me kufijtë kombëtarë të emetimeve, 2018–2024



Në mars të vitit 2021, për shkak të shkeljeve të kufijve të përgjithshëm të NERP-së, Sekretariati i Komunitetit Energjetik hapi një rast kontesti kundër Maqedonisë së Veriut, së bashku me rastet kundër vendeve të tjera. Më 13 korrik 2023, Sekretariati i paraqiti një kërkesë të agumentuar Këshillit Ministror për të marrë një vendim që konfirmonte mosrespektimin, gjë që e bëri në dhjetor 2023.¹¹³ Meqenëse shkeljet nuk janë korrigjuar, që nga maji 2025, rasti mbetet i hapur.¹¹⁴

Investimet aktuale për kontrollin e ndotjes

Më shumë se dy vjet që kur u lëshua leja për Parandalim dhe Kontroll të Integruar të Ndotjes (IPPC) për termocentralin e Bitolës në dhjetor 2022,¹¹⁵ investimet ende mbeten vetëm në letër. Duke marrë parasysh afatet ligjore për tenderim dhe kohën e nevojshme për të zbatuar këto investime të ndërlikuara, tani është e pamundur që termocentrali të bëjë një riparim të plotë të filtrave elektrostatikë deri në dhjetor 2025 ose ndërtimin e një impianti desulfurizimi deri në dhjetor 2026 siç përcaktohet në leje. Këto investime kanë pak kuptim gjithsesi, duke pasur parasysh se Maqedonia e Veriut planifikon të heqë gradualisht qymyrin nga përdorimi deri në vitin 2030, por kjo nuk e ndryshon faktin se termocentrali vazhdon t'i shkelë të gjitha detyrimet kombëtare dhe të Traktatit të Komunitetit Energjetik dhe duhet të ndëshkohet për këtë.

SH.A. ESM i ka dhënë përparësi investimeve për ta zgjatur funksionimin e saj të qymyrit në vend të investimeve në kontrollin e ndotjes. Pavarësisht angazhimit të deklaruar të kompanisë për dekarbonizimin e sektorit të energjisë, një procedurë vlerësimi e ndikimit mjedisor për minierën e linjitet Zhivojno pranë Manastirit rifilloi në mars 2025.¹¹⁶ Miniera sipërfaqësore është planifikuar të jetë rreth 11,5 kilometra katrorë me një prodhim të planifikuar prej rreth 23,6 milionë tonë linjit gjatë 15 viteve. Heqja e shtresës së tokës është planifikuar të bëhet brenda tre viteve nga miratimi i projektit, gjë që e vendos fillimin e shfrytëzimit shumë afër datës së heqjes graduale të qymyrit nga përdorimi në vend.

Sipas Strategjisë së Energjisë së Maqedonisë së Veriut,¹¹⁷ termocentrali Oslomej duhej të mbyllej në vitin 2019. Kjo u zgjat një herë deri në vitin 2021 me NECP-në e parë të vendit,¹¹⁸ dhe tani po zgjatet deri në vitin 2026 sipas draftit të ri të përditësuar të NECP-së.

¹¹³ Këshilli Ministror i Komunitetit Energjetik, [Vendimi 2023/04/MC-EnC mbi mosrespektimin nga Republika e Maqedonisë së Veriut të Traktatit të Komunitetit Energjetik në Rastin ECS-7/21](#), Komuniteti Energjetik, 14 dhjetor 2023.

¹¹⁴ Sekretariati i Komunitetit Energjetik, [Rasti ECS 07/21, Maqedonia e Veriut/Mjedisit](#), Komuniteti Energjetik, qasur më 26 korrik 2024.

¹¹⁵ Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Fizik e Republikës së Maqedonisë së Veriut, [Leja IPPC për AD ESM - dega REK Bitola](#), Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Fizik e Republikës së Maqedonisë së Veriut, dhjetor 2022.

¹¹⁶ Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Fizik e Republikës së Maqedonisë së Veriut, [Lista e VNM-ve](#), Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Fizik e Republikës së Maqedonisë së Veriut, qasur në maj 2025.

¹¹⁷ Ministria e Ekonomisë e Republikës së Maqedonisë së Veriut, [Strategjia e Zhvillimit të Energjisë deri në vitin 2024](#), Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut, 28 dhjetor 2019.

¹¹⁸ Ministria e Ekonomisë e Republikës së Maqedonisë së Veriut, [Plani Kombëtar i Energjisë dhe Klimës](#), Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut, korrik 2020.

Hapat e ndërmarrë nga SH.A. ESM tregojnë se ajo nuk po e merr seriozisht detyrimin e saj për të hequr nga përdorimi gradualisht qymyrin, por në të njëjtën kohë po shmang kryerjen e çdo investimi për të zvogëluar ndotjen jashtëzakonisht të lartë nga termocentralet dhe infrastruktura shoqëruese. Në prill të vitit 2025, pasi zona përreth u mbulua me hirin e qymyrit të nxjerrë nga vendi i asgjësimit, Zyra e Prokurorit Publik hapi rast për të përcaktuar nëse termocentrali po e asgjëson hirin siç duhet.¹¹⁹ – pavarësisht faktit se leja e saj mjedisore thotë se janë marrë masa për të parandaluar daljen e hirit nga vendi. Ajo që është e padiskutueshme: termocentralet duhet t'i përbahen kërkesave dhe të mbyllen.

Maqedonia e Veriut është vendi më i avancuar në rajon për sa i përket planifikimit lidhur me transformimin e energjisë dhe tranzicionin e drejtë, por veprimet e qeverisë dhe SH.A. ESM nuk janë në vijë me dokumentet e saj strategjike. Meqenëse vendi tashmë ka një Udhërrëfyes për Tranzicion të Drejtë¹²⁰ dhe një Plan Investimi për përshpejtimin e tranzicionit të qymyrit,¹²¹ duhet të fillojë të investojë në ato procese në vend të kapaciteteve të reja të qymyrit dhe të shmangë vonesat e mëtejshme lidhur me datën e heqjes të qymyrit nga përdorimi. Investitorët privatë tashmë bëjnë investime të konsiderueshme në termocentrale fotovoltaike dhe të erës, por SH.A. ESM ngel prapa duke iu përmbajtur politikave të vjetra.

Në rishikimet e ardhshme të strategjisë energjetike dhe NECP, vendi duhet të riafirmojë angazhimin e tij për të hequr gradualisht qymyrin nga përdorimi brenda afatit kohor tashmë të rënë dakord. Ndërkohë, duhet të vazhdojë punën për krijimin e një mjedisi që do të mundësojë një kalim më të shpejtë drejt energjisë së rinovueshme, me fokus të theksuar në decentralizimin dhe mbrojtjen e mjedisit jetësor, si dhe duke shmangur rritjen e infrastrukturës së lëndëve djegëse fosile.

Serbia

Harmonizimi me vlerat kufitare të NERP në vitin 2024

Pavarësisht një vendimi të formës së prerë të Gjykatës Supreme të Beogradit nga maji 2023¹²² i cili urdhëron kompaninë shtetërore të energjisë Elektroprivreda Srbije (EPS) që emetimet e SO₂ nga të gjitha termocentralet e saj me qymyr të jenë në përputhje me NERP-në e vendit, investimet e EPS ende nuk kanë treguar rezultate të mjaftueshme dhe madje as termocentralet më të vogla dhe më të vjetra nuk janë mbyllur ende.

Në vitin 2024, emetimet e SO₂ nga termocentralet e qymyrit të përfshira në NERP në Serbi ranë dhe ishin më të ulëta që nga hyrja në fuqi e LCPD, por janë ende 4,6 herë mbi kufirin kombëtar. Emetimet e pluhurit mbetën nën kufirin kombëtar dhe janë në një trend të ngadaltë në rënie. Emetimet e NO_x u ulën shumë pak krahasuar me vitin 2023 dhe ishin në të njëjtin nivel si në vitin 2022. Ajo që ndryshoi në vitin 2024 krahasuar me vitin 2023 ishte kufiri kombëtar për NO_x, i cili u ul ndjeshëm, duke bërë që termocentralet të bëjnë shkelje të NERP.

Emetimet e SO₂ nga termocentralet e qymyrit të përfshira në NERP janë një problem i madh në Serbi. Në vitin 2024, këto termocentrale emetuan 4,6 herë më shumë SO₂ sesa lejohet sipas kufirit të NERP.

Emetimet e SO₂ nga 14 njësitet me qymyr të përfshira në NERP arritën në 205 925 tonë, ndërsa kufiri i vitit 2024 në NERP për 18 termocentrale të mëdha me djegie të brendshme¹²³ arriti një maksimum prej 44 737 tonësh.

Numerikisht, kjo është një rënie e konsiderueshme nga 296 698 tonë të raportuar për vitin 2023, por ende shumë larg përputhjes ligjore dhe sigurisht jo e mjaftueshme për të arritur nivele mjaft të ulëta për të qenë të pranueshme për shëndetin e njeriut.

¹¹⁹ Telma, 'Обвинителството. hulumton si deponira pepelta në REK Bicion', Telma, 21 prill 2025.


¹²⁰ Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut, Udhërrëfyesi i Tranzicionit të Drejtë, Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut, maj 2023.

¹²¹ Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut, Plani i Investimeve për Tranzicionin e Përshpejtuar të Qymyrit për Republikën e Maqedonisë së Veriut – Rajonet e Pelagonisë dhe Jugperëndimit, Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut, janar 2024.

¹²² Instituti Rregullator i Energjisë së Rinovueshme dhe Mjedisit (RERI), Analiza Ligjore e Procedurave Gjyqësore të Iniciuara nga RERI kundër Kompanisë Publike të Energjisë Elektrike të Serbisë për Rrezikimin e Shëndetit të Njeriut, Instituti Rregullator i Energjisë së Rinovueshme dhe Mjedisit (RERI), 6 prill 2024.

¹²³ NERP përfshin gjithashtu njësi me gaz, të tilla si ato në pronësi të NIS në Novi Sad dhe Pančevo, si dhe një rafineri. Ministria për Mbrojtjen e Mjedisit e Republikës së Serbisë, Nacionalni plan za smanjenje emisija glavnih zagađujućih materija koje potiču iz starih velikih postrojenja za sagorjevanje, Shtojca 2, Ministria për Mbrojtjen e Mjedisit e Republikës së Serbisë, shkurt 2020.

Figura 18: Emetimet e dioksidit sulfurik nga termocentralet me qymyr të Serbisë, të përfshira në NERP, krahasuar me kufijtë e lejuar të emetimeve, 2018–2024



Në nivelin e termocentralit, emetuesi më i lartë ishte centrali Nikola Tesla B (njësitë B1 dhe B2) me 76 631 tonë.¹²⁴ – kjo është më e ulët se në vitin e kaluar, por 5,7 herë mbi kufirin individual. Ashtu si në vitin 2023, termocentrali mbetet emetuesi i dytë më i madh në rajon, pas Ugljevikut në Bosnjë dhe Hercegovinë.

Për sa i përket shkeljeve individuale të kufirit, Kostolac A2 emetoi 29 434 tonë, ose 13,2 herë më shumë SO₂ sesa lejohet sipas kufirit individual. Emetimet e SO₂ janë në një trend rritës krahasuar me vitet e kaluara, pasi njësia funksionon pothuajse me orar të plotë gjatë gjithë vitit.


Pasi pajisjet e desulfurizimit të Kostolac B më në fund morën leje operimi në janar 2023,¹²⁵ pas vitesh vonesash dhe operacionesh testuese, në vitin 2024 filloi të tregonte disa rezultate, megjithëse të pakënaqshme. Në vitin 2024, termocentrali emetoi 15 218 tonë SO₂ – prapë 2,3 herë më shumë tonë sesa lejohej të emetonte sipas kufirit të NERP-së, duke ngritur shqetësime serioze në lidhje me cilësinë e pajisjeve dhe funksionimin e saj.

Emetimet e pluhurit ishin nën kufirin kombëtar të NERP-së të Serbisë në vitin 2024 dhe kanë qenë në rënie graduale që nga viti 2018. Megjithatë, në vitin 2024, Kostolac A2 emetoi 3,5 herë më shumë se kufiri i tij individual, dhe Nikola Tesla A1-A3 emetoi mbi 1,5 herë më shumë se sa lejohet. Termocentrali me ngrohje Vreoci gjithashtu e tejkaloi kufirin e vet individual, duke emetuar 4,5 herë më shumë se sa lejohet.

¹²⁴ Agjencia Evropiane e Mjedisit, EIONET, Baza Qendrore e të Dhënave, EIONET, raportuar më 24 Mars 2025.

¹²⁵ Ministria e Ndërtimeve, Transportit dhe Infrastrukturës së Republikës së Serbisë, [Vendimi 351-04-03515/2022-07 për miratimin e funksionimit të njësisë së de-SO_x në Kostolac B](#), Ministria e Ndërtimeve, Transportit dhe Infrastrukturës së Republikës së Serbisë, 11 janar 2023.

Figura 19: Emetimet e pluhurit nga termocentralet me qymyr të Serbisë, të përfshira në NERP, krahasuar me kufijtë e lejuar të emetimeve, 2018–2024



Emetimet e NO_x në Serbi patën një rënie të vogël krahasuar me vitin e kaluar dhe arritën saktësisht të njëjtin nivel si në vitin 2022. Së bashku me një ulje të kufirit të përgjithshëm të NO_x , kjo rezultoi në një shkelje, me emetime 1,14 herë më të larta se sa lejohet.

Viti 2024 shënon vitin e dytë që Serbia ka shkelur kufijtë për dy ndotës. Ngritja e një procedure shkeljeje nga Sekretariati i Komunitetit Energjetik për mosrespektimin e kufirit të NO_x duket të jetë e pashmangshme. Megjithatë, ekziston gjithashtu një kontest ekzistues i inicuar në vitin 2021 për mosrespektim të kufirit të SO_2 .¹²⁶


Lidhur me njësitë individuale, shkelësi më i keq për NO_x në terma absolutë ishte centrali Nikola Tesla B (njësitë B1 dhe B2), me 12 417 ton të emetuar – 1,5 herë më shumë se kufiri individual dhe më i lartë se në vitin 2023. Kostolac A2 emetoi shumë më pak (2 409 tonë), por prapë 1,8 herë më shumë se kufiri i termocentralit.

¹²⁶ Sekretariati i Komunitetit Energjetik, *Rasti ECS 10/21*, Komuniteti Energjetik, qasur më 10 korrik 2024.

Termocentrali i Nikola Tesla, Serbia

Foto: Matteo Trevisan, realizuar si pjesë e projektit fotografik me titull "Më i nevojshëm se dielli"

Figura 20: Emetimet e oksideve të azotit nga termocentralet me qymyr të Serbisë, të përfshira në NERP, krahasuar me kufijtë e lejuar të emetimeve, 2018–2024



Serbia (2024)

Vlera kufitare e SO ₂	Emetimet e SO ₂	Vlera kufitare e pluhurit	Emetimet e pluhurit	Vlera kufitare e NO _x	Emetimet e NO _x
44 737	205 925	5 091	4 203	26 391	30 023

EPS vazhdon të raportojë profit,¹²⁷ por kjo po paguhet nga shëndeti i njerëzve

Në vitin 2023, EPS në pronësi të shtetit raportoi gati 1 miliard euro fitime. Në vitin 2024, këto ranë në 223 milionë euro, pjesërisht për shkak të aktiviteteve intensive të riparimit të përgjithshëm në miniera dhe termocentrale me qymyr, duke përfshirë njësitë Kostolac B1 dhe Nikola Tesla A2,¹²⁸ por mbeti profit i konsiderueshëm. Megjithatë, profiti i kompanisë, edhe pse jo aq i lartë sa në vitin 2023, është rritur nga dështimi i saj për të paguar kostot e saj reale si: funksionimi i paligjshëm i termocentraleve nën regjim 'opt-out', dështimi për të montuar pajisje për de-SO_x dhe de-NO_x në disa nga njësitë e saj ekzistuese, mungesa e çmimeve të karbonit dhe dështimi i përgjithshëm për të internalizuar kostot e jashtme të përballuara nga mjedisi dhe shëndeti i njeriut.

Serbia e mbajti termocentralin e saj të vjetëruar Morava në punë për 2 998 orë të tjera të paligjshme në vitin 2024, duke shkelur regjimin 'opt-out', pasi orët e caktuara të funksionimit kishin skaduar tashmë në fund të vitit 2022. Sekretariati i Komunitetit Energjetik hapi rast kundër Serbisë në tetor 2023, bazuar në një ankesë nga RERI dhe Bankwatch,¹²⁹ por një opinion i argumentuar – hapi tjetër në procedurë – ende nuk është dhënë. Vendimi në këtë rast është vonuar shumë, pasi çdo ditë që kalon, Morava lëshon ndotës vdekjeprurës, duke rrezikuar shëndetin e njeriut dhe mjedisin.

Përveç kësaj, deri në fund të vitit 2023, Serbia kishte shkelur afatin e mbylljes së dy njësive tjera në termocentralin Kolubara. Të dyja njësitë A3-1 dhe A3 3-5 së bashku kishin pak më shumë se 1 000 orë pune në fund të vitit 2022,¹³⁰ dhe të dyja punuan shumë më gjatë se afati i tyre në vitet 2023 dhe 2024. Kolubara A5 nuk i shfrytëzoi të gjitha 20 000 orët e saj deri në fund të vitit 2023, por gjithsesi do të mbyllej për shkak të skadimit të periudhës së operimit. Megjithatë, vazhdoi të operonte në vitin 2024 për 1 414 orë.

¹²⁷ Vladimir Spasić, 'EPS e Serbisë shënon një profit vjetor prej 223 milionë eurosh', *Lajme për Energjinë e Gjellbër në Ballkan*, 3 shkurt 2025.

¹²⁸ Po aty.

¹²⁹ Sekretariati i Komunitetit Energjetik, 'Sekretariati nis procedurën e kontestit kundër Serbisë për shkelje të Direktivës së Termocentraleve të Mëdha me Dëgjie të Brendshme në rastin e TC Moravës'.

¹³⁰ Sekretariati i Komunitetit Energjetik, *Raporti Vjetor i Zbatimit të Serbisë 2023, Komuniteti Energjetik*, 12 nëntor 2023.

Planet e Serbisë në lidhje me mbylljen dhe nxjerrjen nga përdorimi të termocentraleve Morava dhe Kolubara A janë ende të paqarta dhe rrezikojnë thelbin e LCDP-së, pasi sipas Strategjisë së Zhvillimit të Energjisë të Republikës së Serbisë deri në vitin 2040, ato do të hiqen nga rrjeti vetëm 'deri në vitin 2030' për arsye të sigurisë energjetike.¹³¹ Prandaj, duket se Serbia po synon në mënyrë të njëanshme të legalizojë shkeljet dhe të "zgjasë" afatin për pajtueshmërinë me IED-në përmes dokumenteve të saj strategjike – gjë që është ligjërisht e pamundur.

Në tetor 2024, EPS shpalli¹³² një tender që mbulon si zhvillimin e një projekti konceptual për procesin e konservimit ashtu edhe përgatitjen dhe dorëzimin e kërkesave për shqyrtim të vlerësimit të ndikimit mjedisor për nxjerrjen nga funksioni të termocentraleve Kolubara A dhe Morava. Kontrata u dha më 23 janar 2025 dhe afati i përfundimit të punimeve nuk është përcaktuar qartë, por në mënyrë indikative, në rreth 300 ditë nga dorëzimi i të gjitha dokumenteve të nevojshme.¹³³ Mungesa e një afati të qartë mbart me vete një rrezik të lartë që procedura të zgjatet pa nevojë, duke e vonuar potencialisht datën e mbylljes për shumë vite, ndërsa termocentralet vazhdojnë të operojnë në mënyrë të paligjshme.

Investimet aktuale për kontrollin e ndotjes

Gjatë vitit 2024, njësia e desulfurizimit në Kostolac B1 dhe B2 ishte në funksionim deri diku, por, siç u përmend më parë, emetimet e saj mbeten dy herë më të larta se kufiri individual i SO_x, duke bërë që kjo të jetë dështim. Gjersa NERP ofron fleksibilitet në lidhje me kontributet individuale të termocentralit në kufirin e përgjithshëm kombëtar të emetimeve, nga 1 janari 2028 e tutje, termocentrali duhet të përmbushë vlerat më të rrepta kufitare të emetimeve të Direktivës për Emetimet Industriale, diçka që duket shumë e pamundur për momentin.

Sipas një analize nga RERI, impianti de-SO_x i Kostolac B mund të ketë qenë jashtë funksionit për të paktën 40 përqind të kohës në vitin 2024. Kjo për shkak se prodhoi 183 957 tonë gips si rezultat 450 000 tonë në vit.¹³⁵

Përveç kësaj, gazrat e oxhakut nuk monitorohen vazhdimisht në impiant, gjë që përbën shkelje të neneve 12 dhe 13 të LCDP-së.¹³⁶ Sipas raportit mjedisor të EPS për vitin 2023, 'pas desulfurizimit, gazrat e gazrat e mbetura shkarkohen përmes një oxhaku të ndërtuar rishtazi, mbi të cilin janë instaluar pajisje automatike për matje të vazhdueshme, për të cilat TC Kostolac B ka miratimin e Ministrisë kompetente për matje të pavarura të vazhdueshme të emetimeve. Kur impianti i desulfurizimit nuk është duke punuar, gazrat e mbeturinave shkarkohen përmes sistemit të vjetër për trajtimin e gazrave të mbeturinave vetëm me një precipitator elektrostatisht, pa kryer matje të vazhdueshme.'

Në prill të vitit 2024, u raportua se njësia e desulfurizimit me vlerë 215 milionë euro në termocentralin Nikola Tesla A3-A6 ishte vënë në punë¹³⁷ 13 vjet pas sigurimit të financimit.¹³⁸ Raporti vjetor Mjedisor i EPS thekson se impianti i desulfurizimit të gazrave të oxhakut filloi punën provuese në vitin 2024, duke raportuar përfundim 100% të punimeve në fund të vitit dhe se ishte paraqitur një kërkesë për leje operimi.¹³⁹ Njësitë ende emetonin më shumë se dyfishin e dioksidit të sulfurit nga sa lejohej në vitin 2024.

Fillimi i punimeve për të montuar pajisjet e desulfurizimit në termocentralin Nikola Tesla B – emetuesi i dytë më i lartë i SO₂ në vend pas termocentralit Kostolac B – u shpallë në dhjetor 2020, me një afat përfundimtar deri në vitin 2024.¹⁴⁰ Megjithatë, vlerësimi i ndikimit të tij në mjedis u miratua vetëm në mars të vitit 2022.¹⁴¹ EPS raportoi se punimet ishin përfunduar në masën 91 përqind në fund të vitit 2024.¹⁴²

Për Kostolac A, EPS bëri një ofertë për një studim fizibiliteti mbi instalimin e pajisjeve të desulfurizimit¹⁴³ në tetor 2020, me qëllim zgjatjen e operimit të termocentralit për 15 vjet.¹⁴⁴ Megjithatë, në vitin 2022 kompania filloi ta rishqyrtojë këtë vendim dhe anoi drejt mbylljes¹⁴⁵ siç ishte, në fakt, plani origjinal kur NERP u hartua për herë të parë në vitin 2016. Në vitin 2023, si pjesë e planit Go Green Road të EPS, u njoftua se termocentrali do të mbyllet në fund të vitit 2028.¹⁴⁶ Për shkak të mungesës së investimeve në kontrollin e ndotjes, nuk ka gjasa që emetimet e saj të ulen para kësaj kohe. Në të njëjtin njoftim, EPS njoftoi gjithashtu se mbyllja e Moravës dhe Kolubara A ishte planifikuar në vitin 2024, gjë që është vonuar tashmë, duke i zgjatur më tej shkeljet e tyre të ndotjes.

¹³¹ Ministria e Energjisë dhe Minierave, [Strategjia e Zhvillimit të Sektorit të Energjisë e Republikës së Serbisë deri në vitin 2040 me parashikime deri në vitin 2050](#), Qeveria e Serbisë, 36, korrik 2024.

¹³² Ruzhica Vranjković, ["Počeo proces gašenja termoelektrana – prvo najstarije, "Kolubara A" i "Morava", RTS, 28 tetor 2024.](#)

¹³³ Vendimi për dhënien e kontratës, nr. 1201-31799/2-25, i datës 23 janar 2025 dhe kontrata shabllon, si pjesë e dokumentacionit të tenderit, qasur nga RERI.

¹³⁴ EPS, [Raporti Mjedisor 2024](#), 127, Mars 2025.

¹³⁵ EPS, [Termocentrali EPS si shembull i një projekti të suksesshëm](#), 28 prill 2021.

¹³⁶ Sipas Shtojcës VIII, pjesa A, pika 2.

¹³⁷ Igor Todorović, ["Mitsubishi Power vë në punë sistemin e desulfurizimit në termocentralin e qymyrit TENT A të Serbisë", Lajme për Energjinë e Gjelbër në Ballkan](#), 25 prill 2024.

¹³⁸ Svetlana Jovanović, ["Nis ndërtimi i sistemeve të desulfurizimit të gazrave të oxhakut në termocentralin me qymyr TENT A", Lajme për Energjinë e Gjelbër në Ballkan](#), 14 shkurt 2019.

¹³⁹ Shoqëria Aksionare Elektroprivreda Srbije, [Raporti Mjedisor 2024, JSC EPS](#), 70, Mars 2025.

¹⁴⁰ Vladimir Spasić, ["Emetimet e SO₂ nga termocentrali i qymyrit Nikola Tesla B do të reduktohen për 20 herë deri në vitin 2024", Lajme për Energjinë e Gjelbër në Ballkan](#), 2 dhjetor 2020.

¹⁴¹ Elektroprivreda Srbije, [Raporti Mjedisor 2023, Elektroprivreda Srbije](#), 77, Prill 2024..

¹⁴² Shoqëria Aksionare Elektroprivreda Srbije, [Raporti Mjedisor 2024](#), 83.

¹⁴³ Nina Domazet, ["EPS namjerava proizvesti život TE Kostolac A", Energetika-net](#), 19 tetor 2020.

¹⁴⁴ Vladimir Spasić, ["EPS planifikon të zgjasë periudhën e funksionimit të TEC Kostolac A deri në vitin 2038", Lajme për Energjinë e Gjelbër në Ballkan](#), 15 tetor 2020.

¹⁴⁵ Vladimir Spasić, ["EPS po shqyrton mbylljen e termocentralit me qymyr Kostolac A", Lajme për Energjinë e Gjelbër në Ballkan](#), 29 korrik 2022.

¹⁴⁶ Vladimir Spasić, ["EPS përcakton planin për mbylljen e termocentraleve me qymyr"](#).



Termocentrali i Nikola Testa, Serbia

Foto: Matteo Trevisan, realizuar si pjesë e projektit fotografik me titull "Më i nevojshëm se dielli"

Plani trevjeçar i biznesit i EPS për periudhën 2025 deri në 2027,¹⁴⁷ i miratuar nga kompania më 31 janar 2025, përmban plane për investime të mëtejshme në kontrollin e ndotjes. Kompania planifikon të investojë 100 milionë euro shtesë në termocentrale të ndryshme, por nuk i ndan qartë këto investime. Plani përmend vetëm se përparësia do të jetë vënia në funksion e njësive të desulfurizimit në termocentralet Nikola Tesla A dhe Nikola Tesla B, si dhe denitrifikimi në Kostolac B.

Në Kostolac B2 janë bërë disa punë për të ulur emetimet e NO_x me një sistem për matjet parësore të instaluar në vitin 2019 dhe një rezervuar për lëngun e amoniakut si masë dytësore të instaluar në vitin 2023.¹⁴⁸ Rezultatet nuk janë ende të qarta, por është e qartë se nevojitet dhe planifikohet punë shtesë.

Në përgjithësi, megjithëse EPS po instalon gradualisht pajisje për kontrollin e ndotjes në termocentralet e saj, projektet ose nuk kanë qenë mjaftueshëm efektive, si me de-SO_x në Kostolac B, ose janë disa hapa prapa realitetit ligjor dhe ekonomik.

Pavarësisht kësaj, EPS ka investuar tashmë shuma të mëdha fondesh në desulfurizim. Kjo është e nevojshme, pasi këto termocentrale nuk mund të mbyllen menjëherë por as nuk mund të vazhdojnë të ndotin në nivelet aktuale. Por këto investime janë gjithashtu të kushtueshme dhe konsumojnë energji, duke i bërë kështu termocentralet edhe më pak efikase. EPS me siguri do të paguajë çmimin për përdorimin e ngadaltë të energjisë së erës dhe asaj solare, pasi qymyri bëhet gjithnjë e më pak konkurrues sapo të përcaktohen çmimet e CBAM ose të karbonit. Plani aktual i kompanisë që të kufizojë eksportet e energjisë elektrike në vendet jo-anëtare të BE-së derisa të përjashtohet nga CBAM¹⁴⁹ duket jorealistic meqenëse Serbia është fqinje me katër vende të BE-së.

Nuk është e qartë nëse Serbia ka një plan për ta trajtuar këtë, pasi NECP-ja e saj, e miratuar në fund të korrikut 2024, ishte me cilësi të dobët dhe e vështirë për t'u deshifruar.¹⁵⁰ Strategjia e Zhvillimit të Energjisë e Serbisë deri në vitin 2040,¹⁵¹ e miratuar në nëntor 2024, gjithashtu ka mungesë të detajeve dhe nuk arrin të caktojë një datë të qartë për heqjen graduale të qymyrit nga përdorimi para vitit 2050.

¹⁴⁷ Elektroprivreda Srbije, [Plan biznesi trevjeçar për periudhën 2025-2027](#), Elektroprivreda Srbije, 12-13, 31 janar 2025.

¹⁴⁸ Elektroprivreda Srbije, [Raporti Mjedisor 2023](#), 113.

¹⁴⁹ Elektroprivreda Srbije, [Plan biznesi trevjeçar për periudhën 2025-2027](#), 9.

¹⁵⁰ Qeveria e Serbisë, [Integrirani nacionalni energetski i klimatski plan republike Srbije za period do 2030. sa vizijom do 2050. Godine](#).

¹⁵¹ Ministria e Minerave dhe Energjisë e Republikës së Serbisë, [Strategjia Zhvillimore e Energjisë e Republikës së Serbisë deri në vitin 2040 me parashikime deri në vitin 2050](#), Kuvendi Kombëtar i Republikës së Serbisë, 27 nëntor 2024.

Konkluzione

Nivelet e ndotjes nga termocentralet me qymyrit të Ballkanit Perëndimor shtatë vjet pas afatit për zbatimin e LCPD mbeten jashtëzakonisht të larta.

Në vitin 2024, emetimet e të tre ndotësve sërisht shkelën vlerat kufitare të përcaktuara në NERP-ët e Bosnjë e Hercegovinës, Kosovës, Maqedonisë së Veriut dhe Serbisë.

Me shtrëngimin e kufirit për të gjithë ndotësit në vitin 2024, shkeljet e vendeve janë edhe më të këqija se në vitet e kaluara. Por kufijtë më të rreptë nuk e marrin parasysh këtë më vete, pasi Bosnja dhe Hercegovina rriti ndjeshëm emetimet e dioksidit të sulfurit, duke u bërë për herë të parë emetuesi më i lartë në rajon.

Në përgjithësi, ndotja me SO_2 nga termocentralet e qymyrit të përfshira në NERP ishte gjashtë herë më e lartë se sa lejohej, krahasuar me 5,7 herë në vitin 2023. Ndotja nga pluhuri ishte 1,8 herë më e lartë se sa lejohej, krahasuar me 1,75 herë në vitin 2023, dhe ndotja nga NO_x ishte 1,35 herë më e lartë se sa lejohej, krahasuar me 1,3 herë në vitin 2023.

Edhe pse Sekretariati i Komunitetit Energjetik ka hapur raste për të gjitha shkeljet, dhe CBAM, problemet teknike dhe prodhimi i ulët i qymyrit në disa vende mund ta përshpejtojnë mbylljen e termocentraleve të qymyrit në rajon, nevojitet më shumë presion mbi qeveritë dhe shërbimet publike dhe një planifikim më i mirë i një heqjeje graduale dhe të menaxhuar të qymyrit nga përdorimi. Pas shtatë vitesh shkeljesh, asnjë operator nuk është gjobitur për mosrespektimin e rregullave në rajon.

Shumë kohë është humbur: tani ekziston një rrezik serioz i një heqjeje graduale të paplanifikuar të qymyrit nga përdorimi, me ndikime të panevojshme e të ashpra në komunitetet e varura nga qymyri, të cilat mund të ishin shmangur me një planifikim të duhur. Është veçanërisht shqetësuese që shumica e vendeve të Ballkanit Perëndimor nuk kanë arritur të miratojnë NECP-të ose t'i përditësojnë ato ekzistuese deri më tani, pasi nevojiten urgjent plane të qarta dhe vendimtare.

Politikanët dhe kompanitë e shërbimeve pa dyshim do të përpiqen ta fajësojnë BE-në dhe CBAM-in për këtë situatë, por e vërteta është se ata e kanë shkaktuar vetë këtë situatë duke mos arritur të planifikojnë dhe të bëjnë investimet e duhura. Qeveritë dhe kompanitë e shërbimeve kanë qenë në dijeni të afatit të vitit 2018 të LCPD-së qysh nga viti 2005, kur u nënshkrua Traktati i Komunitetit Energjetik, dhe e kanë ditur qysh nga viti 2019 që CBAM do të zbatohet.

Në vend që të instalonin pajisje për kontrollin e ndotjes në vitet 2000-ta dhe fillim të viteve 2010 e tutje, kur kjo mund të kishte kuptim në disa raste, vendet humbën vite të tëra duke u përpjekur të ndërtonin termocentrale të reja me qymyr, edhe pse ishte tashmë e qartë se qymyri nuk kishte të ardhme. Vetëm Stanari në Bosnjë dhe Hercegovinë dhe Kostolac B3 në Serbi janë vënë në punë, duke e shpëtuar kryesisht rajonin nga një bllokim shtesë i kushtueshëm me qymyr, por ky shpërqendrim i ka lënë vendet me një flotë termocentralesh të paligjshme dhe të dobëta me qymyr dhe pa kursime të mjaftueshme energjie ose zhvillim të energjisë së erës dhe solare për të mbushur boshllëkun pasi të mbyllen.

Rekomandimet

Qeveritë e Ballkanit Perëndimor duhet që më në fund ta marrin përgjegjësinë për heqje graduale e të menaxhuar të qymyrit nga përdorimi dhe të ndalojnë së lejuari që shërbimet e energjisë të zvarrisin pafundësisht uljen e emetimeve. Nevoja për ta ulur ndotjen dhe për ta rritur efikasitetin e energjisë dhe format e qëndrueshme të energjisë së rinovueshme është më e madhe se kurrë. Për të siguruar që tranzicioni energjetik në gjashtë vendet e Ballkanit Perëndimor të jetë transparent, i përgjegjshëm dhe i drejtë, roli i parlamenteve kombëtare, organeve rregullatore të pavarura dhe shoqërisë civile duhet të rritet. Ato duhet të përfaqësohen sistematikisht në mbikëqyrjen e pavarur të zbatimit të parimit 'themelet në radhë të parë' (sundimi i ligjit, të drejtat themelore, forcimi i institucioneve demokratike) në tranzicionin energjetik. Roli i parlamenteve kombëtare në procesin e vendimmarrjes duhet gjithashtu të forcohet ndjeshëm, duke rritur njohuritë e tyre për problemet dhe duke i përfshirë ato në mënyrë më kuptimplote në vendimmarrje.

Qeveritë dhe shërbimet e energjisë duhet t'i respektojnë angazhimet e tyre: termocentralet që operojnë sipas regjimit të përjashtimit duhet të mbyllën menjëherë,¹⁵² dhe termocentralet e përfshira në NERP duhet t'i përmbahen kufijve të tyre. Më urgjentisht, njësitë e desulfurizimit Ugljevik dhe Kostolac B duhet të fillojnë të funksionojnë siç duhet. Investimet e vazhdueshme në desulfurizim duhet të përshpejtohen dhe, ndërkohë, orët e funksionimit duhet të reduktohen për të ulur barrën e ndotjes. Asgjësimi i mbeturinave dhe trajtimi i ujërave të zeza që vijnë nga desulfurizimi duhet të zgjidhet në një mënyrë të shpejtë dhe të planifikuar mirë, veçanërisht duke pasur parasysh rrezikun e lartë të ndotjes mjedisore në të ardhmen.

Kërkesa duhet të reduktohet edhe me masa të tjera, si afatshkurtra ashtu edhe me sistematike, siç janë zvogëlimi i humbjeve në shpërndarje, izolimi i ndërtesave dhe përdorimi i pompave eficiente të nxehtësisë për ngrohje në vend të ngrohësve me rezistencë elektrike. Masave të tilla duhet t'u jepet përparësi shumë më e lartë se sa është aktualisht.

Planet Kombëtare të Energjisë (NECP) përfundimtare dhe/ose të përditësuara të vendeve duhet të përmbajnë plane realiste për një heqje graduale e të menaxhuar të qymyrit nga përdorimi, bazuar në gjendjen reale teknike të termocentraleve të tyre, nivelin e investimeve të nevojshme për t'i sjellë ato në përputhje me kontrollin e ndotjes, si dhe rezervat e tyre të linjimit dhe kapacitetin e prodhimit. Maqedonia e Veriut dhe Mali i Zi në veçanti duhet t'i sqarojnë urgjentisht datat e heqjes graduale të qymyrit nga përdorimi, pasi ato mund të jenë të parat në rajon.

Ndikimet e CBAM duhet të integrohen në këto plane pasi këto do të ndikojnë tejmasë në funksionimin e termocentraleve të qymyrit, veçanërisht në Bosnjë dhe Hercegovinë, Mal të Zi dhe Maqedoninë e Veriut.¹⁵³ Në teori, vendet mund të marrin përjashtime nëse plotësojnë kushte të tilla si bashkimi i tregut, futja e sistemeve të tregtimit të emetimeve në nivelin e Sistemit të Tregtimit të Emetimeve të BE-së deri në vitin 2030 dhe përputhshmëria me legjislacionin përkatës të BE-së, por me progresin e bërë deri më tani, kjo duket e pamundur.

Edhe pse përgjegjësia kryesore është qartë e qeverive të Ballkanit Perëndimor, edhe institucionet e BE-së duhet t'i përshpejtojnë veprimet e tyre, duke përdorur të gjitha mjetet në dispozicion, të tilla si kushtëzimi i financimit të BE-së dhe progresit të anëtarësimit me pajtueshmërinë; dërgimi i mesazheve të qarta politike publike; dhe sigurimi i financimit për një tranzicion të drejtë të rajoneve të qymyrit dhe kalimin në ngrohje të qëndrueshme qendrore. Komisioni duhet të propozojë instrumente më të forta zbatimi për Traktatin e Komunitetit Energjetik, në dobi të shëndetit të njeriut dhe mjedisit. Nëse Traktati do të nxisë më tej dekarbonizimin dhe integrimin e tregut, mekanizmi i tij i zgjidhjes së mosmarrëveshjeve duhet të forcohet për të përfshirë dënime dekurajuese për shkeljet.

¹⁵² Mundësia tjetër është t'i nënshtrohem një rindërtimi të madh për të përmbushur vlerat kufitare të emetimeve për termocentralet e reja sipas Traktatit të Komunitetit Energjetik, siç po përpiqet të bëjë termocentrali i Pljevljes, por ne jemi skeptikë se kjo do të ishte e realizueshme ekonomikisht.

¹⁵³ Ioana Ciuta dhe Pippa Gallop, [Sektori i Energjisë në Ballkanin Perëndimor - Midis krizës dhe tranzicionit](#).

Për të gjitha qeveritë e Ballkanit Perëndimor

- Të mbyllen menjëherë termocentralet me funksionim të afatizuar.
- Të zvogëlohen orët e funksionimit për termocentralet që nuk janë të harmonizuara, me qëllim që të respektojnë vlerat kufitare të emetimeve të përcaktuara në NERP, ndërsa pajisjet e kontrollit të ndotjes të funksionojnë ose termocentralet të mbyllen.
- Të miratohen Planet Kombëtare të Energjisë dhe Klimës me plane të qarta dhe transparente për mbylljen graduale të të gjitha termocentraleve të qymyrit dhe datat e përgjithshme të heqjes graduale të qymyrit dhe lëndëve djegëse fosile nga përdorimi. Planet duhet të marrin në konsideratë ndikimet e mundshme të çmimeve të karbonit dhe/ose Mekanizmit të Rregullimit të Kufirit të Karbonit në vitet e ardhshme, dhe duhet të shmangin shpërqendrimet e kushtueshme, siç është përdorimi i gazit.
- Të rriten investimet në masat e efikasitetit të energjisë diellore, erës dhe për përmirësime të nevojshme në rrjetet ekzistuese, për të ulur humbjet dhe për të lejuar më shumë lidhje të burimeve të rinovueshme, si dhe përdorimin e pompave efikase të nxehtësisë për amvisëritë në vend të ngrohësve me energji elektrike, në mënyrë që të minimizohet nevoja për të mbajtur në funksion termocentralet e vjetra me qymyr. Të shtohet mbikëqyrja e mjedisit jetësor dhe pjesëmarrja e publikut për të minimizuar rezistencën që ka ndaj investimeve diellore, të erës dhe investimeve në rrjet.
- Të kryhen inspektive efektive mjedisore të termocentraleve të mëdha me djegie të brendshme sipas NERP-së dhe regjimeve me funksion të afatizuar, me qëllim identifikimin e shkeljeve të rregulloreve kombëtare të mbrojtjes së ajrit dhe zbatimin e masave dhe sanksioneve të duhura aty ku është e aplikueshme.
- T'i kushtohet vëmendje më e madhe planifikimit pjesëmarrës nga poshtë-lart për një tranzicion të drejtë në ato termocentrale dhe marrjes së vendimit se cilat miniera qymyri do të mbyllen të parat.

Për autoritetet e Bosnjës dhe Hercegovinës

- T'i vënë në punë menjëherë dhe vazhdimisht pajisjet e desulfurizimit në Ugljevik. Të kryejnë monitorim në kohë reale për t'u siguruar që desulfurizimi po përdoret gjatë gjithë kohës.
- Të merren masa të menjëhershme për t'i zvogëluar emetimet e pluhurit në Gacko, duke zvogëluar orët e funksionimit dhe/ose duke instaluar pajisje të reja, bazuar në një vlerësim realist të periudhës së mbetur të funksionimit të termocentralit.
- Të anulohet vendimi për zgjatjen e kohës së funksionimit të Tuzla 4 dhe Kakanj 5 dhe të mbyllen termocentralet. Të zyrtarizohet mbyllja e Tuzla 3.
- Të shqiptohen dënime mbi EP BiH dhe ERS për shkelje të kufijve të NERP, dhe mbi EP BiH për vazhdimin e funksionimit të Tuzla 4 dhe Kakanj 5 nëse ato vazhdojnë të funksionojnë pasi vendimi i tyre për zgjatjen e kohës së funksionimit të jetë revokuar.
- Të zvogëlohen menjëherë orët e funksionimit të të gjitha termocentraleve që po shkelin kufijtë e NERP-së.
- Të miratohet drafti i Planit të Integruar të Energjisë dhe Klimës me sqarime në lidhje me planet për heqjen graduale të qymyrit nga përdorimi dhe një justifikim ekonomik për çdo investim të mëtejshëm të planifikuar për kontrollin e ndotjes, siç janë investimet e desulfurizimit në Kakanj 7 dhe Tuzla 6, duke marrë parasysh ndikimet e CBAM, prodhimin e qymyrit dhe gjendjen teknike të termocentraleve. Të caktohen data më të hershme të mbylljes për Gacko, Kakanj 6 dhe Tuzla 5, pasi nuk ka gjasa që investimet e konsiderueshme në kontrollin e ndotjes të jenë të realizueshme për këto njësi.
- Kur kryhen vlerësime të ndikimit në mjedis për masat e reduktimit të emetimeve, të sigurohet që studimet e VNM-së të përmbajnë informacion të detajuar mbi teknologjinë që do të përdoret, çfarë do të bëhet me nënproduktet dhe rezultatet e pritura në aspektin e reduktimit të emetimeve.
- Të anulohen termocentralet e reja të planifikuara me qymyr Ugljevik III dhe Gacko II dhe të shmanget zëvendësimi i termocentraleve të qymyrit të BiH-së me një termocentral të ri me gaz.

Preporuke vlastima na Kosovu

- Së paku, të shqiptohen dënime bindëse ndaj KEK-ut për shkeljen e kufijve të emetimeve të NERP.
- Të reduktohen menjëherë orët e funksionimit të të gjitha njësive për t'i sjellë ato në përputhje me kufijtë e tyre të NERP-së, veçanërisht në lidhje me emetimet e pluhurit nga Kosova B.

- Të fillojë mbyllja e Kosova A, njësi pas njësie, pasi duket shumë e pamundur që investimet e mëtejshme në kontrollin e ndotjes të jenë ekonomisht të justifikueshme për një termocentral të kësaj vjetërsie. Të rivlerësohet urgjentisht justifikimi ekonomik për investimin e planifikuar prej 137 milionë eurosh në Kosova A3 dhe investimet e tjera të planifikuara në Kosova A.
- Të përshpejtohen punimet e rikonstruksionit për përputhje me standardet e emetimeve të pluhurit dhe NO_x në termocentralin Kosova B. Të publikohen informacione të përditësuara mbi statusin e projektit dhe një justifikim për vonesat e shumta dhe të sigurohet përfundimi i shpejtë i projektit për të përmirësuar monitorimin e vazhdueshëm në termocentralin Kosova B.

Për autoritetet e Malit të Zi

- Së paku, të shqiptohen gjopa bindëse ndaj EPCG-së për operimin e paligjshëm të termocentralit të qymyrit në Plevlja.¹⁵⁴
- Të hartohet një plan rezervë në rast se modernizimi i Plevljës nuk shkon sipas planit.
- Të ndryshohet drafti i NECP-së për t'u zotuar për një vit të heqjes graduale të qymyrit nga përdorimi më realist se viti 2035, bazuar në ndikimet e pritura të CBAM-it dhe/ose rritjes së çmimeve të karbonit në vend.

Për autoritetet e Maqedonisë së Veriut

- Së paku, të shqiptohen gjopa bindëse ndaj SH.A. ESM për shkelje të kufijve të NERP.
- Të formalizohet mbyllja e REK Oslomej dhe TEC Negotino.
- Të shmangen vonesat e mëtejshme në heqjen graduale të planifikuar të qymyrit dhe të mos hapen miniera të reja të qymyrit.
- Të adresohet urgjentisht mungesa e monitorimit të vazhdueshëm në termocentralet e mëdha me djegie të brendshme.
- Të zvogëlohet SO₂ dhe ndotja nga pluhuri nga termocentrali i Bitoles duke i mbajtur orët e funksionimit sa më të ulëta që është e mundur për t'iu përmbajtur kufijve derisa termocentrali të mbyllet.

Për autoritetet e Serbisë

- Të urdhërohet mbyllja e termocentraleve të qymyrit në Moravë dhe Kolubarë, ose të paktën të vendosen gjopa penguese ndaj EPS për operimin e tyre të paligjshëm.
- Të mundësohet zbatimi i vendimit përfundimtar të Gjykatës Supreme në Beograd, i cili urdhëroi EPS që emetimet e SO₂ nga termocentralet e saj me qymyr të jenë në përputhje me kufijtë vjetorë të emetimeve të NERP të vendit.
- Urgjentisht t'i jepen sqarime publikut pse emetimet e SO₂ nga Kostolac B vazhdojnë të jenë kaq të larta, pavarësisht nga instalimi i një njësie de-SO_x dhe çfarë bëhet për ta rregulluar këtë. Ndërkohë, të ulen orët e funksionimit dhe të publikohen të dhënat e emetimeve në kohë reale në internet.
- Inspektoratet përgjegjëse duhet të kryejnë pa vonesë inspektime të impiantit të de-SO_x dhe trajtimit të ujërave të ndotura në Kostolac B dhe të përcaktojnë nëse po zbatohen masat e kërkuara për mbrojtjen e mjedisit.
- Të publikohen të dhënat e emetimeve në kohë reale në internet për njësinë e re Kostolac B3 të vënë në punë në dhjetor 2024.
- Të jepen informata të përditësuara mbi statusin e projektit të desulfurizimit të Nikola Tesla A3-A6 dhe të publikohen të dhënat e emetimeve në kohë reale në internet.

¹⁵⁴ Ndryshimet në Ligjin për Emetimet Industriale në dhjetor 2022 nuk e bëjnë funksionimin e tij më pak të paligjshëm – shih Raportin e vitit 2023 [Permbaju ose Mbyll](#) për më shumë detaje.

- Të sigurohet përfundimi në kohë dhe efektiv i projektit aktual për instalimin e pajisjeve të desulfurizimit në Nikola Tesla B1 dhe B2. Të sigurohet që trajtimi i ujërave të zeza dhe asgjësimi i vazhdueshëm i gipsit të jenë funksionale para përfundimit, për të shmangur vonesat në funksionimin e desulfurizimit pasi të ketë përfunduar projekti.
- Duke marrë parasysh që në termocentralet kryesore me qymyr të Serbisë janë përfunduar ose janë në zhvillim e sipër investimet në desulfurizim, fokusi për pjesën e mbetur të termocentraleve tani duhet të jetë në planifikimin për mbylljen dhe tranzicionin e drejtë të punëtorëve dhe rajoneve më të gjera, në varësi të termocentraleve.

Për Komunitetin Energjetik

- Sekretariati duhet të vazhdojë të ndihmojë Palët Kontraktuese në finalizimin e Planeve të tyre Kombëtare Energjetike dhe Klimatike, me rritjen e investimeve në format e qëndrueshme të energjisë së rinovueshme, përcaktimin e çmimeve të karbonit, duke parandaluar përdorimin e gazit dhe duke u përgatitur për një tranzicion të drejtë.
- Duke pasur parasysh mosrespektimin e vazhdueshëm të kërkesave për dioksidin sulfurik dhe shkeljet për oksidet e azotit në vitet 2023 dhe 2024, ne i bëjmë thirrje Sekretariatit të lëshojë një opinion të argumentuar për Serbinë në lidhje me shkeljet e saj të NERP dhe të hapë një rast në lidhje me njësitë e mbetura me funksionim të afatizuar.
- I bëjmë thirrje Këshillit Ministror që të konfirmojë shkeljen e Traktatit të Komunitetit Energjetik nga Plevlja pa vonesa të mëtejshme.

Për Komisionin Evropian dhe Shtetet Anëtare të BE-së

- Të fillojë forcimi i Traktatit të Komunitetit Energjetik për të siguruar gjoba shkurajuese në rastet e mosrespektimit.
- Të sigurohen fonde shtesë dhe të dedikuara për një tranzicion të drejtë të rajoneve të qymyrit dhe ngrohjes qendrore të qëndrueshme në Ballkanin Perëndimor, duke përfshirë fondet në dispozicion të drejtpërdrejtë të autoriteteve lokale.
- Të sigurohet që përjashtimet e mundshme nga CBAM sipas Nenit 2(7) të Rregullores të zbatohen në mënyrë rigorozepër vendet e Ballkanit Perëndimor.
- Të sigurohet që përputhshmëria me LCPD-në të integrohet si kusht në çdo fond të ardhshëm të BE-së për rajonin, veçanërisht ato që veprojnë mbi parimin e Instrumentit për Reformë dhe Zhvillim.
- Për ta adresuar mungesën e përputhshmërisë me Direktivën për Termocentralet e Mëdha me Djegie të Brendshme dhe Direktivën për Emetimet Industriale, të theksohet rëndësia e zbatimit në nivel kombëtar, duke kërkuar një rol më aktiv për inspektoratet dhe zbatim para gjyqësorit kombëtar.
- Të caktohen tregues solid të sundimit të ligjit për monitorimin e progresit në tranzicionin energjetik, veçanërisht në lidhje me menaxhimin e shëndoshë të fondeve dhe pajtueshmërinë me legjislacionin e Komunitetit Energjetik.
- Të sigurohet që financimi i BE-së dhe ai ndërkombëtar të mos mbështesë gazin në mënyrë që të shmanget përdorimi i mëtejshëm lëndëve djegëse fosile.

Shtojca 1

Materialet dhe metodologjia

Të dhënat për emetimet e termocentraleve me qymyr të Ballkanit Perëndimor u mbledhën nga [EIONET Central Data Repository](#). Të dhënat për vitin 2024 do të verifikohen vetëm nga Agjencia Evropiane e Mjedisit Jetësor brenda disa muajve të ardhshëm.

Ku ka qenë e mundur, kemi përdorur shifra të verifikuara të emetimeve nga Agjencia Evropiane e Mjedisit Jetësor për periudhën nga viti 2018 deri në vitin 2023, e për shkak të përditësimit, disa të dhëna mund të jenë ndryshe nga ato të cituara në raportet e mëparshme të Përmbaju ose Mbyll. Planet Kombëtare të Zvogëlimit të Emetimeve që kemi përdorur janë dokumente zyrtare të publikuara nga secili prej vendeve. Vlerat e përgjithshme të nivelit të vendit të përdorur si referencë përfshijnë, në disa raste (p.sh. Serbia), vlerat kufitare të emetimeve nga objektet tjera që nuk janë termocentrale me qymyr (p.sh. rafineritë), gjë që shpjegon pse në ato raste vlerat kombëtare janë më të larta se shuma e vlerave individuale të termocentraleve me qymyr.



CEE Bankwatch
Network

QERSHOR 2025